Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (32). DHJETOR 2008. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

Redaksia ju uron gjithë lexuesve dhe bashkëpunëtorëve Gëzuar Vitin e Ri

2009!

OPINION

Kthimi i Gjergj Gjon Kastriotit në vendlindje

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 7

INVESTIME

Djersa për vendlindje më kënaq shpirtin

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 9

SHËNIME

Shqipëria është e vogël në hartë, inxhinier!

Nga: **VESEL HOXHA** - FAQE 10

BOTIME

Botohet libri "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit"

Nga: **Prof. Dr. BASHKIM LLESHI** - FAQE 14

SHENIM

Pazari

Nga BUJAR KAROSHI

Prej kohësh kam ndjekur me vë mendje gjithë procesin për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës. Ajo që bie në sy kohët e fundit është PAZARI! Më duket sikur "Skavica" është ngritur dhe është ulur në mes të Tiranës dhe 6 kompani të huaja kërkojnë ta blejnë, ndërsa gjithë ata që përmbyten kërkojnë ta marrin "Skavicën" dhe ta ulin në breg të Drinit të Zi dhe aty ta bëjnë Pazarin!

Të kërkosh të ndërtosh një vepër të madhe energjetike, me kaq rëndësi të madhe për vendin, natyrisht që është një përgjegjësi e qeverisë dhe atyre që hartojnë politikat e zhvillimit, por të kërkosh që një gjë të tillë ta bësh pa pyetur qytetarët e këtij vendi, kjo është një gjë antidemokratike. Prandaj, në këtë kontekst, qeveria duhet të hapë një fushatë informimi, e cila më pas duhet të ndiqet me një referendum popullor.

Në një vend me demokraci, kurrë nuk mund të vijë progresi, në qoftë se pjesë e këtij progresi nuk bëhen qytetarët. Por, ndërsa përfaqësuesit e popullit e kanë lënë krejt në mëshirë të qeverisë "Çështjen Skavica", është vetë populli që kërkon të marrë situatën në dorë. Por, ata e ndjejnë veten të humbur, kur përballë u vihen argumentet se "Skavica është një vepër madhore", "Skavica i duhet Shqipërisë", "Skavica mbyll kaskadën mbi Drin", "Skavica është vepër kombëtare", etj. Dhe janë të humbur, pikërisht se përballë këtyre fjalëve të mëdha, nuk duan ta ndjejnë veten më pak atdhetarë se kryeministri i vendit, deputeti i tyre, kryetari i komunës apo kryeplaku i fshatit.

Duke mos pasur argumentet e mjaftueshme dhe të nevojshme për t'iu kundërvënë "interesave kombëtare" të mësipërme, atë kthehen tek e vetmja e drejtë kushtetuese, juridike dhe morale: Mbrojtja e pronës së tyre! Që në të vërtetë, duket si çështje pazari. "Askush nuk ka të drejtë të shesë pronën që na kanë lënë të parët tanë" mbrohen anëtarët e Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi, por duke harruar se kështu kanë rënë në kurthin që të ofron pazari. Po dole në treg je i detyruar të shesësh dhe të blesh, ndryshe je i falimentuar! Dhe për t'i shpëtuar falimentimit duhen njerëz të tjerë! Duhen njerëz që nuk e presin me pushkë Hajredin Pashën që po vjen Radikës, por i shtrojnë tavolinën dhe i thonë "Bujrum, ja kushtet tona!"

Gjashtë kompani në garë për Skavicën



- Më datë 5 janar 2009, komisioni i vlerësimit të ofertave do të shpallë shoqëritë e kualifikuara për në fazën e dytë.
- Hyjnë në garë një shoqëri italiane, një koreanojugore, një norvegjeze, dy austriake dhe një gjermane.
- Reagon shoqata "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi": "Kryetarët e komunave kanë dhënë miratimin për Skavicën".
- Të dielën, 28 dhjetor, shoqata ka njoftuar një tubim në qytetin e Peshkopisë, për ti thënë "JO" ndërtimit të hidrocentralit.
- Reagojnë dhe shoqatat mjedisore: Ministritë e kanë detyrim kushtetues bërjen publike të vlerësimit mjedisor dhe kulturor të zonës që përmbytet nga ndërtimi i hidrocentralit.

LEXONI NE FAQET 2-3

REPORTAZH NË RRUGËN E ARBËRIT - Nga **SHAQIR SKARRA** - FAQE 4,5

Te ura që bashkon dy rrugë

KRYEMINISTRI SALI BERISHA PËR RRUGËN E ARBËRIT:
"Do të ndërtohet rruga e Arbrit. Ne do ta bëjmë edhe atë. Do t'i bëjmë të gjitha rrugët tona, sepse janë rrugë që shqiptarët i meritojnë. Të jem i sinqertë me ju, shikoja trasenë e kësaj rruge dhe mendja më shkonte te Rruga e Arbrit. Ne do ta bëjmë edhe atë, ne do t'i bëjmë rrugët tona sepse janë rrugë që shqiptarët i meritojnë".



Asfalti i parë në Rrugen e Arbërit...

Gazeta "Rruga e Arbërit" vazhdon të mirëpresë mendimet dhe opinionet në vazhdim të debatit për ndërtimin ose jo të Hidrocentralit të Skavicës

Rruga Arbërit nr. 32

debat

Posta e Rruga Arbërit

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Agron Tufa, Viron Kona, Sakip Cami, Perikli Jorgoni, Selman Mziu, Ymer Keta, Xhelal Roçi, Ali Hoxha, Kujtim Boriçi, etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Redaksia:
Në Dibër:
Rexhep Torte
Në Athinë:
Abdurrahim Ashiku
Në Itali:
Selman Mziu
Në New York:
Beqir Sina
Në Tiranë:
Prof. Dr. Bashkim Lleshi,
Naim Plaku

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. (04) 2233 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Gjashtë kompani në garë për Skavicën

Në datën 17 Dhjetor 2008, pas një ftese ndërkombëtare të shpallur nga Ministria e Ekonomisë, u hap faza e parë e procedurës konkurruese, ajo e parakualifikimit të ofertuesve për Hidrocentralin e Skavicës. Në këtë fazë shoqëritë i nënshtrohen kritereve specifike të hollësishme që kanë të bëjnë me kapacitetet e tyre financiare dhe experiencën në vepra energjetike të ngjashme.

Në parakualifikim u paraqiten si ofertues gjashtë shoqëri të njohura ndërkombëtare, me eksperience shumëvjeçare në ndërtim dhe operim të hidrocentraleve.

Konkretisht u paraqitën shoqëritë:

Konsorciumi Italian TGK në përbërje të të cilit janë shoqëri italiane me eksperiencë në fushën e projektimit dhe ndërtimit të veprave energjetike.

Korea Electric Power Corporation, që është Korporata Energjetike e Koresë së Jugut, që siguron energji elektrike prej 120 vjetësh, zhvillon projekte energjetike në disa vende të botës.

STATKRAFT, shoqëri norvegjeze e cila është një nga shoqëritë më të rëndësishme energjetike në Europë.

VERBUND - shoqëri Austriake që zotëron rreth 90 hidrocentrale. Aktualisht, në Shqipëri VERBUND është e angazhuar në ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit të Ashtës.

KELAG GRUP është një nga konsorciumet më të mëdhenj të prodhimit të energjise në Austri.

"R.W.E" AG, shoqëri gjermane, e cila kontrollon rreth 2800 MË nga energjia hidrike.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Ekonomisë, brenda datës 5 janar 2009 komisioni i vlerësimit të ofertave do të shpallë shoqëritë e kualifikuara për në fazën e dytë, atë të paraqitjes së ofertave të projekteve, prodhimit të energjisë, fuqisë së instaluar etj.

Skavica, sipas qeverisë shqiptare, shpallet kështu si një nga projektet më të rëndësishme koncesionare në lidhje me energjinë hidrike. Hidrocentrali i Skavicës është shkalla e peste dhe e fundit e skemës së shfrytëzimit hidroenergjetik të lumit Drin ose thënë ndryshe hidrocentrali i kreut të kaskadës së Drinit.

Parashikohet që kjo vepër energjetike e ndërtuar mbi lumin Drini i Zi të ketë fuqi të instaluar nga 300-400 MegaWat.

REAGIMI


Prej kohësh, shoqata "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi", ka reaguar ndaj procedurave që po ndjek qeveria shqiptare prej gati 10 vitesh, për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Sipas kryetarit të saj, z. Nazmi Drizi, kjo shoqatë e cila numëron mbi pesë mijë anëtarë, nuk është dakord me procedurat e deritanishme për ndërtimin e hidrocentralit. Sipas zotit Drizi, qeveria, ajo e Fatos Nanos dhe kjo e Sali Berishës, nuk kanë ndjekur në këto procedura asnjë interes të komunitetit që përmbytet nga ujrat e hidrocentralit.

Në një emision televiziv në "Dibra Vizion", drejtuesit e kësaj shoqatë, Nazmi Drizi, Ali Hoxha, Sadin Përnezha, Shaban Beqa, Murat Koltraka, Osman Begu, etj, kanë mbrojtur idenë se qeveria shqiptare duhet ti ndërpresë menjëherë procedurat e mëtejshme për dhënien me koncesion të hidrocentralit të Skavicës.

> Më datë 5 janar 2009, komisioni i vlerësimit të ofertave do të shpallë shoqëritë e kualifikuara për në fazën e dytë

> Hyjnë në garë një shoqëri italiane, një koreanojugore, një norvegjeze, dy austriake dhe një gjermane

> Reagon shoqata "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi": "Kryetarët e komunave kanë kanë dhënë miratimin për Skavicën"



> Bashkë me tokën janë detyruar të lëvizin mbi 30 mijë banorë të kësaj zone, përmbyten mbi 4 mijë ha tokë pemtore. Prodhimi vjetor i këtij pellgu vlerësohet me rreth 80-100 milionë dollarë. Gjithë dëmi ekonomik të vlerësohet nga qeveria me rreth 40 milionë dollarë, sa gjysma e prodhimit vjetor të kësaj zone. Toka vlerësohet me vetëm 1 euro/m2, sa një paketë cigare."

"Një vit më parë, më 13 dhjetor 2007, kjo shoqatë ka marrë një kontakt me ministrin e ekonomisë, z. Genc Ruli. Ai na premtoi dhe garantoi se për hidrocentralin e Skavicës qeveria shqiptare nuk do të bëjë asnjë hap pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatës dhe mendimin e komunitetit" – thotë presidenti i nderit i shoqatës, Ali Hoxha, njëri nga themeluesit. "Në të vërtetë ndodhi krejt e kundërta, thekson Ali Hoxha. Prej asaj kohe, përfaqësues të firmave që duan të marrin hidrocentralin kanë takuar pushtetarë vendorë, por mendimin e komunitetit nuk e kanë marrë kurrë".

Sipas Ali Hoxhës, deri më tani ka një terr informacioni mbi atë çka do ndodhë me Skavicën, ku do shpërngulen njerëzit, me çfarë do kompensohen dhe sa do kompensohen, etj.

"I gjithë ky terr informativ dhe me aq informacione sa kemi mundur të sigurojmë privatisht, thota Ali Hoxha, na bëjne të besojmë se me Skavicën po ndodh një aferë e madhe korruptive, e ngjashme me Gërdecin".

Sipas përfaqësuesve të kësaj shoqate, sipërfaqja që përmbytet në pellgun e lumit Drin është 8 mijë ha. "Kjo është toka më pjellore e gjithë Dibrës, thotë Osman Begu, dhe përbën dy të tretën e sipërfaqes. Bashkë me tokën janë detyruar të lëvizin mbi 30 mijë banorë të kësaj zone, përmbyten mbi 4 mijë ha tokë pemtore të reja dhe të vjetra, do të zhduken mbi 10 mijë krerë lopë të rracave më të mira që janë sot në Evropë. Prodhimi vjetor i këtij pellgu vlerësohet me rreth 80-100 milionë dollarë, çka tregon për falsitetin e atij projekti ogurzi që kërkohet të bëhet në pellgun e kësaj zone, saqë gjithë dëmi ekonomik të vlerësohet me rreth 40 milionë dollarë, sa gjysma e prodhimit vjetor të kësaj zone. E çuditshme është fakti që kjo tokë vlerësohet me vetëm 1 euro, aq sa kushton sot rëndom në Dibër një kokër lakër, e cila kultivohet për jo më shumë se 2 deri në 3 muaj, ose e thënë më troç, sa një

"Intelektualët e zonës së Dibrës duhet të kërkojnë vlerësimin mjedisor që është bërë për këtë projekt. Kjo është e drejta e tyre dhe detyrim ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës".



GJASHTË SHOQËRITË PJESMARRËSE

1. **Konsorciumi Italian TGK** në përbërje të të cilit janë shoqëri italiane me eksperiencë në fushën e projektimit dhe ndërtimit të veprave energjetike.
2. **Korea Electric Power Corporation**, që është Korporata Energjetike e Koresë së Jugut, që siguron energji elektrike prej 120 vjetësh, zhvillon projekte energjetike në disa vende të botës.
3. **STATKRAFT**, shoqëri norvegjeze e cila është një nga shoqëritë më të rëndësishme energjetike në Europë.
4. **VERBUND** - shoqëri Austriake që zotëron rreth 90 hidrocentrale. Aktualisht, në Shqipëri VERBUND është e angazhuar në ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit të Ashtës.
5. **KELAG GRUP** është një nga konsorciumet më të mëdhenj të prodhimit të energjise në Austri.
6. **"R.W.E"** AG, shoqëri gjermane, e cila kontrollon rreth 2800 MW nga energjia hidrike.

paketë cigare."

Përfaqësuesit e shoqatës kanë renditur edhe një sërë arsyesh të tjera ekonomike, sociale, historike, etnokulturore etj, mbi rreziqet që sjell Hidrocentrali i Skavicës.

TAKIMI ME PUSHTETARËT LOKALË

Megjithëse prej të paktën katër vitesh është folur shpesh për Skavicën, vetëm njëra nga 6 firmat konkuruese ka shkuar të takojë përfaqësues të pushtetit vendor. Sipas kryetarit të shoqatës "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi", më 27 nëntor, në një nga lokalet e qytetit të Peshkopisë, përfaqësues të firmës "STATKRAFT" kanë takuar kryetarët e komunave të Dibrës dhe Bulqizës si dhe përfaqësues të prefekturës. Në një takim të tillë, përfaqësuesit e firmës, kanë shpjeguar para kryetarëve të komunave, projektin e tyre mbi Skavicën. Të pranishëm pa ftesë në këtë takim, përfaqësuesit e shoqatës, u kanë bërë me dije përfaqësuesve të firmës, se "Kryetarët e komunave nuk e kanë të drejtën të lidhin a firmosin asnjë lloj marrëveshje për sa u përket pronave të tyre. Sipas Nazmi Drizit, gjithë kryetarët e komunave të Dibrës e Bulqizës, kanë firmosur një marrëveshje, e cila do i vendosë ata para përgjegjësisë para popullit".

Menjëherë pas këtij takimi, përfaqësuesit e Shoqatës "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi" kanë takuar prefektin e Dibrës, të cilit i kanë bërë të ditur qëndrimin e tyre dhe e kanë informuar prefektin mbi atë çka ndodhi në një takim, që sipas Nazmi Drizit, ishte një akt i pastër korrupsioni dhe shpërdorimi detyre.

REAGIMI I PREFEKTIT

Në një letër drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, prefekti i Dibrës, Xhafer Seiti, e ka informuar atë mbi takimin me përfaqësues të shoqatës dhe njëkohësisht mbi atë çka ka ndodhur në takimin me përfaqësues të pushtetit lokal. Prefekti Seiti rekomandon në këtë letër, se në procesin e vazhdimit të tenderimit, duhen marrë parasysh edhe kërkesat e banorëve që përmbyten nga ujëmbledhësi i Hidrocentalit të Skavicës.

REAGIMI QYTETAR

Megjithatë, megjithëse drejtues të shoqatës "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi" deklarojnë se kanë në gjirin e tyre mbi 5000 mijë anëtarë, ata asnjëherë nuk kanë mundur të bëjnë një tubim me më shumë se 30 veta. Sipas njërit nga përfaqësuesit e shoqatës, kjo ka ndodhur për arsye se nuk duam të nxisim akte vandalizmi dhe dhune. Njerëzit janë shumë të irrituar për atë çka po ndodh, por ne kërkojmë të jemi të arsyeshëm dhe qeveria të gjejë gjitha modalitetet e nevojshme për ti dhënë zgjidhje problemit në të mirë të dyja palëve.

"Ne e duam zhvillimin, por nuk mund të lejojmë që pronat tona të dhunohen sikur të jenë pa zot. Ky vend ka zot dhe ne do ta mbrojmë".

Përfaqësuesit e shoqatës "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi" kanë njoftuar mbajtjen e një mitingu në qytetin e Peshkopisë të dielën më 28 dhjetor. Për këtë ata kanë njoftuar Drejtorinë e Policisë në qark si dhe kanë shpërndare thirrje në të gjitha komunat ku rrezikohet përmbytja nga hidrocentrali.

Korresp. "Rruga e Arbërit"

Shkruan ambientalisti Xhemal Mato

"UNË RRESHTOHEM ME JU"

- Nga letërkëmbimet me Abdurahim Ashikun

Përshëndetje Abdurahim,

E lexova shkrimin tuaj dhe problemi mu duk shumë i rëndësishëm dhe kompleks. Unë vetë mësova shumë gjëra dhe kuptova që pak e njoh problematikën që do të sjellë ndërtimi i Skavicës. Mendoj se intelektualët e zonës së Dibrës duhet të kërkojnë vlerësimin mjedisor që është bërë për këtë projekt (është e drejta e tyre dhe detyrim ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës). Gjithashtu me ligj ata kanë të drejtë ta anulojnë, në se nuk janë dakord dhe argumentojnë ato që ju përmendni me të drejtë. Kjo është rruga ligjore por si e dini dhe ju, ligjet shpërfillen në këtë drejtim në Shqipëri, kështu që ngel hapi i dytë gjyq, i cili gjithashtu nuk fitohet kollaj dhe s'e merr përsipër ta bëjë një grup i pa bashkuar, shpesh i pamotivuar në ndërgjegje. Se fundi është gjyqi publik të cilin ju jeni duke e bërë por këtu të gjithë që janë dakord me ju duhet ta bëjnë dhe unë tashmë rreshtohem pas jush.

Nëntë ide për të parandaluar katastrofën dibrane

Të nderuar anëtarë të shoqatës "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi"

Unë e hodha në publik mendimin dhe protestën time qytetare për të parandaluar katastrofën dibrane, për të mos e mbytur atë. Jam larg dhe nuk jam në kontakt me dibranët për të përjetuar reagimin e tyre. Deri tani, me përjashtim të Xhemal Matos dhe një kosovari, mësues në Finlandë, nuk kam pas asnjë prononcim. Kjo më duket si "hallvë e ftohtë". Ndoshta masin pulset, ndoshta "tundin kokën për të mbledhë mendtë", megjithatë unë gjykoj se duhet vepruar. Po si?

Unë kam disa mendime që dua t'ju a parashtroj.

1. Në skenë duhet të dalë me zë të plotë "Shoqata për mbrojtjen e pellgut të Dibrës", të dalë me një program të plotë e me argumente të plota.
2. E domosdoshme është krijimi i një fondacioni të natyrës "FONDACIONI PËR MBROJTJEN E DIBRËS". Pa një fondacion të tillë nuk mund të bëhet asnjë hap ligjor e prezantues të problemit.
3. Duhet të botohet një gazetë, qoftë edhe duke bashkëpunuar me gazetën "Rruga e Arbrit" apo "Dibra", me financime nga ky fondacion, dhe këto gazeta të dalin më shpesh, mundësisht njëjavore. Me një numër në muaj nuk mund të përballohet volumi i madh i problemeve për tu evidentuar.
4. Shpejt duhet të kalohet në një konferencë shkencore me referime të njerëzve të nivelit akademik për të sqaruar në detaje problemin.
5. Duhen skicuar hapat që duhen bërë për mbrojtjen e Dibrës nga mbytja, hapa që përfshijnë gjykatat e të gjitha niveleve (deri në Strasburg), referendum popullor, etj.
6. Të gjenden që tani avokatët më të mirë dibranë që vullnetarisht apo me një shpërblim modest të mbrojnë çështjen.
7. Gazetat, në qoftë se do ta marrë përsipër mbrojtjen propagandistike, duhet të bëjë një plan të hollësishëm për të ftuar në faqet e saj personalitete të larta të historisë, hidroenergjetikes etj.
8. Të shihet mundësia e botimit të një broshure të vogël me thirrjen time dhe thirrjen e shoqatës për mbrojtjen e pellgut të Dibrës si dhe ndonjë material tjetër për ta çuar problemin tek të gjithë dibranët, në Dibër, në Tiranë e Durrës (kudo ku janë shpërngulur) por edhe jashtë, në Evropë, SHBA, Kanada etj.
9. Të bisedohet me drejtues të televizioneve private për një debat televiziv "Pro" dhe "Kundër" ndërtimit të HEC të Skavicës.

Këto ishin disa mendime paraprake. Mua më keni të gatshëm që të vij edhe në Shqipëri për të dhënë ndihmesën time.

Përshëndetje!
A. ASHIKU

Athinë, 28 nëntor 2008

Rruga Arbërit nr. 32

reportazh

Lugina e Bulqizës është kthyer në një kantier të madh ndërtimi. Ky segment prej 16.9 km është ndarë në tre lote, ku punojnë tetë kompani shqiptare.

Te ura që bashkon dy rrugë

Nga SHAQIR SKARRA

Mëngjezi i dhjetorit është i ftohtë e temperaturat janë ulur. Shirat kështu siç ja kanë nisur shpejt do të sjellin borën. Fundja majë malet janë mbuluar nga një tis i hollë bore e cila është shtrirë edhe poshtë duke bllokuar dhe disa rrugë në zonat malore. Bashkë me Naim Plakun u nisëm herët drejt luginës së Bulqizës, aty ku ka filluar të gjarpërojë rruga e Arbërit . Nga Tirana u nisëm herët me qëllim që të ktheheshim përsëri vonë në darkë. Nuk di se si por sa herë që udhëton drejt vendlindjes një ndjesi malli të ndjek pas gjatë gjithë udhëtimit Qafën e Buallit e ngjitëm kur mëngjezi kishte filluar të zbardh e rrezet e diellit kishin përflakur majën e Dhoksit.

- Kjo është një nga qafat më të rrezikshme, e thyen heshtjen Naimi pas një udhëtimi të gjatë nëpër monotoninë e natës . Thonë se këtu ka ngrirë edhe bualli kallkan, ndryshe nuk ka se si t'i ketë mbetur ky toponim i çuditshëm. Sado që dielli është shfaqur me tërë madhështinë e tij e ka humbur atë ngrohtësi që ka në stinën e verës e qyteti i Bulqizës është i ftohtë. Qyteti duket si i fjetur se nuk e ka gjallërinë e dikurshme kur këtu dhe nata vite më parë nuk ishte e pa gjumë. Megjithatë sapo kanë filluar lëvizjet e pakta në bulevard e qepenat e dyqaneve janë ngritur lart. Kjo tregon se dhe këtu ku temperaturat janë nën zero jeta vazhdon normalisht e njerëzit kërkojnë që t'i kthehen punës.

-Bulqiza ka pritur dhe përcjellë shumë, thotë Naimi. Këtu kanë ardhur vazhdimisht gazetar dhe njerëz të artit, pushtetar të rangjeve të larta por dhe turist. Atëherë të gjithë sytë i kishin tek Bulqiza, tek ky qytet i vogël minator strukur rrëzë maleve. E sot Bulqiza është e braktisur, dikur qytet i zhurmëshëm e plot gjallëri, tani duket si i përgjumur gjatë gjithë ditës. Ja si është katandisur Bulqiza që kishte eksportin e kromit më të madh në shkallë vendi dje. Sot shkëlqimin e këtij qyteti minator e ka zënë mjerimi dhe themi me bindje se mund ta quajmë si qytet të mjerimit shqiptar, një ndër qytetet më të varfëra në shkallë vendi. Fytyrat e zverdhura të minatorëve, nënat e kërrusura e gratë me rroba të zeza.

Fëmijët me çantat e shkollës me gur kromi e varfëria e tejskajshme kudo.

Kjo është Bulqiza . Nesër ndoshta do të jetë ndryshe. E me këtë shpresë flenë në darkë dhe vetë bulqizakët. Ndoshta nesër do të ketë një të ardhme ky qytet i strukur bukur rrëzë maleve dhe vetëm atëherë kur të shqetësohet shteti, kur miniera e kromit të shfrytëzohet me kriter, kur Qafa e Buallit të shpohet tej e tej nga rruga e Arbërit. Atëherë mund dhe duhet të rrezatojë një fije shprese edhe për këtë qytet ku sot është përhumbur në vorbullën e mjerimit. Pse jo të mos jetë ky qytet një lagje e Tiranës. Mbas përfundimit të rrugës së Arbërit vetëm 70 km e ndajnë Bulqizën nga Tirana.

> Ja deri tani që po flasim në këtë lot është realizuar vlera totale në masën 80%. Kemi kryer gërmimet në masën 98% nga 195000 metra kub dhe e shkëmb që kemi patur sipas projektit. Janë kryer shtresa rrugore 75% e gjithë shumës së projektit. Janë realizuar veprat e artit në masën 98%. Shtresa asfaltike në masën 58%. Dhe shpreh bindjen time të plotë se jamë më së shumti kushtet atmosferike që na penguan ndoshta dhe mund të kishim realizuar objektivin para kohe.



LUGINA E BULQIZËS, NJË KANTIER NDËRTIMI

Makina e la pas qytetin e Bulqizës në atë monotoninë e tij të fjetur e vetëm pak metra më poshtë të shfaqet një tjetër pamje, një tjetër realitet krejt ndryshe. Këtu ka filluar pikërisht ajo që vitet e fundit në media është quajtur si rruga e Arbërit. Në krah të majtë të rrugës një kantier ndërtimi. Asfalti i sapo hedhur gjarpëron që poshtë luginës dhe zgjatet e zgjatet drejt Urës së Çerenecit. Rruga vende vende ka devijuar dhe është hapur totalisht trase e re, është drejtuar shumë, është zgjeruar dhe tashmë sytë e kujtdo shohin një autostradë moderne. Aty ku dikur ka qenë një lapidar në kujtim të betejës së famshme të Vajkalit e sot nga punimet e rrugës së Arbërit nuk është më, na priste inxhinier Shaban Bitri i cili i strukur i tëri në një xhup të madh nuk donte të ia dinte fare për të ftohtin e Bulqizës. Shabani vjen shpesh në Bulqizë pasi është administrator i kompanisë "Almo Konstrusion" e cila aktualisht punon në lot 3 të segmentit Bulqizë-Ura e Çerenecit.


-Kjo luginë është kthyer në një kantier të madh ndërtimi, thotë Shabani. Ky segment prej 16. 9 km është ndarë në tre lote ku punojnë tetë kompani shqiptare. Këtu nis lot 1 ku punojnë dy firma nga Shkodra.

Ka një vit nga dita kur këtu u ndje për herë të parë zhurma e eskavatorëve dhe gjëmimi i eksplozivit e sot pas një viti është një realitet tjetër. Edhe një sy i pa stërvitur mirë e kupton se këtu prej një viti po punohet në mënyrën më intensive. Në të dalë të kantierit Hasan Hafizi, administrator i kompanisë "Albavia" së bashku me Shkëlqim Rakipin, administrator i kompanisë "Karl Gega". Që të dy shkodranë dhe është hera e parë që po punojnë në Bulqizë

-Kjo është një vepër për nga rëndësia e madhe, futet në bisedë Hasani, ndoshta e dyta pas asaj të rrugës Durrës-Kukës, është një vepër që bashkon lindjen me perëndimin. Një rrugë e kategorisë së parë ku gjërësia e saj arrin në dhjetë metra. Ne jemi munduar që tju përmbahemi objektivave por kushtet e vështira që kemi hasur nuk i kemi arritur ato.

Kishim dëgjuar për Bulqizën si zonë e ftohtë e me ngrica por nuk e besonim që do të hasnim edhe vështirësi të tjera siç ishte qarkullimi i mjeteve e sigurimi i rrugës. Megjithatë i ftohti karakteristik i Bulqizës ka qenë ndër më kryesorët që na ka penguar në realizimin e objektivave.

Shtresat asfaltike duan domosdo një temperaturë konstante për tu hedhur e këtu në Bulqizë temperaturat ndryshojnë. Po kështu dhe betonet nuk mund të hidhen kur ka ngri-









reportazh

Bulqizë-Ura e Çerenecit do të përfundojë brenda vitit 2009.
Po kështu, edhe segmentet Bulqizë-Klos dhe Klos-Shkalla e Tujanit do të përfundojnë brenda vitit 2009



ca. Për sigurinë e rrugës jemi detyruar që ta sigurojmë vetë me fuqinë puntore që disponojmë. Pas një viti pune intensive shpreh im bindjen se megjithë mend është punuar në këtë segment rruge. Të gjithë fuqinë puntore i kemi marrë nga zonat që kalon traseja e rrugës, thotë Shkëlqimi, e kjo është bërë në bashkëpunim me komunat dhe fshatrat përkatës. Sot volumi i punës se kryer është në masën 80% ku ka mbetur vetëm shtresa asfaltike pasi gërmimet, shtresat dhe veprat e artit kanë përfunduar. Është gërmuar dhe çvendosur 81000 m3 dhe e realizuar në masën 100%. Janë realizuar deri tani shtresa rugore në masën 75%. Kemi realizuar deri tani shtresa asfaltike në masën 50%. Janë realizuar veprat e artit në masën 98%. Ky nuk është një volum pune i vogël e kur është punuar në një kohë edhe me kushte atmosferike të vështira karakteristike këto për këtë zonë.

Traseja shtrihet poshtë luginës e makina rrëshqet me shpejtësi përgjatë kësaj traseje të re të sapo asfaltuar. Sapo kalon Fushë-Bulqizën në trasenë e re të rrugës, e pranë urës së qytetit fillon lot 2. Edhe këtu një tjetër kantier ndërtimi. Dy kompani të tjera "Delia Group" me administrator Viktor Delia nga Puka dhe "Euraldi SHPK" me administrator Ilir Bulku nga Peshkopia. Një distancë jo e vogël ka devijuar tashmë rrugën ekzistuese e cila ka braktisur dhe urën me harqe të qytetit, ndërtuar në periudhën romake duke lënë këtu thjeshtë një toponim, dhe tashmë po përfundon ura e re e cila pret trarët që të bashkojë dy krahët e Zallit të Bulqizës, urë kjo me një hapsirë drite por 21 metra e gjatë. Traseja e rrugës kalon fare pranë gurëve të Skëndërbeut dhe zgjatet përsëri poshtë luginës sipër fshatit Peladhi ku në Krajkë bashkohet me lot 3. Iliri ka punuar dhe në vende të tjera, dhe në rrugë të tjera, po kështu dhe Viktori por kjo rrugë për to ishte dhe një përvojë më shumë. Pikërisht tek ura takuam Ilirin dhe Viktorin.

-Do ta bashkojmë zallin shpejt , thotë Iliri dhe ajo ura tjetër do të mbetet vetëm si toponim për të treguar se në cilën periudhë kohe është ndërtuar.

Ja deri tani që po flasim në këtë lot është realizuar vlera totale në masën 80%. Kemi kryer gërmimet në masën 98% nga 195000 metra kub dhe e shkëmb që kemi patur sipas projektit. Janë kryer shtresa rrugore 75% e gjithë shumës së projektit. Janë realizuar veprat e artit në masën 98%. Shtresa asfaltike në masën 58%. Dhe shpreh bindjen time të plotë se jamë më së shumti kushtet atmosferike që na penguan ndoshta dhe mund të kishim realizuar objektivin para kohe.

URA E ÇERENECIT

Ura e Çerenecit i thonë e kështu do të vazhdojë të quhet. E njohur më së shumti u bë por kjo u bë këtë vit kur nisi të ndërtohet segmenti i parë i rrugës së Arbërit. Më parë askush nuk kishte dijeni për këtë urë të thjeshtë që bashkonte brigjet e një zalli me ujë të pakët në verë e të rrëmbyer në stinën e dimrit. Ura e Çerenecit së shpejti do të jetë ura që do të bashkojë dy rrugë , dy arterie të rëndësishme të vendit tonë .

Segmenti i parë i rrugës së Arbërit ka nisur pikërisht këtu për t'u zgjatur drejt Tiranës. Shumë shpejt do të nis segmenti tjetër i kësaj rruge drejt Maqedonisë. Këtu do të nis segmenti për në Peshkopi e pastaj drejt Kukësit, Hasit, Qafë-Prush e Tropojë.

Përsëri Ura e Çerenecit-Steblevë-Librazhd-Korçë-Ersekë. Do të jetë kjo që do të quhet si unaza e madhe e lindjes. Pra Ura e Çerenecit bashkon dy arteriet më të rëndësishme të vendit tonë që në një të ardhme të shpejtë do t'i japin një tjetër impuls transportit dhe zhvillimit të vendit, do të kryqëzojë dy rrugët më të rëndësishme veri –lindje dhe lindje perëndim. Pikërisht këtu tejk kjo urë fillon dhe lot 3 i rrugës së Arbërit dhe një nga pjesët më të vështira të këtij segmenti. Jo pak por në këtë lot punojnë tre kompani shqiptare si: "Almo Konstruksion" me administrator Shaban Bitri, "Ulza ndërtim" me administrator Nikolin Shtëpani, "GPG" me administrator Paqësor Buzi. "Almo Konstruksion" në nëntor u vlerësua nga BID, qendër për vlerësimin e biznesit në Londër, cmimin për cilësinë QC 100 .

Kjo pjesë ka qenë ndër pjesët më të vështira me gërmime dhe vepra arti. Rruga ekzistuese këtu nuk duket fare, ajo është shpërbë dhe vendin e saj e ka zënë një trase krejt e re, me skarpata të larta e mure të shumtë.

-Ja e shikoni këtë usekun e madh që thellësia arrin mbi 13 metra thellësi? Shoferi Ibrahim Doçi parkoi makinën e tonazhit të rëndë diku aty pranë dhe u bë pjesë e bisedës tonë. Edhe ne nuk na mbushej mendja në fillim se do të çahej kjo kodër e madhe. Ja sot se si është bërë dhe nuk bindet tashmë njeri se dikur ka qenë një lartësi mali e madhe po të mos shikojë këto skarpata që shkojnë deri në 23 metra të larta e gjatësia shkon në 350 metra. Rruzhdi Bitri që para pak kohësh në këtë segment rruge e pikërisht këtu tek varrezat e Sofraçanit gjeti një përkrenare ilire thotë:-Në këtë lot nuk është vetëm ky usek që shohim por janë hapur 2 të tillë me gjatësi 350 metra e tjetri me 102 metra ku skarpatat arrijnë deri në 20 metra lartësi.Në pjesën e parë prej 3 km pothuajse 2 km është aksi i ri . Para nesh shfaqej një autostradë moderne, bashkëkohore me të gjitha parametrat që duhen.

Bashkë me Naimin u strukëm paksa nga era e fortë që frynte, dukej sikur po shkulte dhe drurët e pyllit e Shabani as që donte të ia dinte për erën.

I strukur në atë xhupin e madh, me flokët e thinjura që i ishin shpupurisur nga era debatonte më eskavatoristët dhe puntorët e sigurisë rrugore. Shabani është natyrë shumë e mbyllur, jo kur është në objekt por dhe ditë të tjera është vështirë që të shikosh fytyrën e tij të qeshur dhe ashtu siç ishte gjithë nerva u afrua pranë nesh.


-Punë e vështirë kjo me njerëzit por ja që duhet e dhe kjo se fundja një do ta bëjë. Nuk di si na ra për hise por fakt është se ky lot është një nga më të vështirët në të gjithë segmentin e kësaj rruge. Kemi patur si pas projektit 3520000 metra kub gërmime dheu dhe shkëmbi si dhe çvendosjen e tij. Deri tani e kemi realizuar në masën 98% duke gërmuar dhe çvendosur 280000 metra kub dhe e shkëmb. E kemi patur të vështirë dhe çvendosjen e dheut e shkëmbit të gërmuar pasi distanca ishte e largët e trafiku tepër i ngarkuar. Nga gërmimi në skarpata të larta afro 40 metra dhe useqe kemi hasur vështirësi të tjera ku kemi përdorur fuqinë puntore për sigurinë rrugore. Deri tani është realizuar vlera totale në masën 80%. Gërmimet në masën 98% apo 280000 metra kub. Shtresat rrugore janë realizuar në masën 72%. Shtresat asfaltike janë realizuar deri tani në masën 45%. Veprat e artit 98%. Vepra të mëdha arti siç është ura tek përroi i keq me dy hapsira drite nga 21 metra gjatësi është realizuar nënstruktura ku vetëm trarët mbeten për vitin tjetër. Është kjo një vepër arti e vështirë pasi vetëm trarët do të vonojnë pasi do të derdhen në vend se nuk ka mundësi të punojë vinçi në të dyja krahët e urës. Na është dashur që të gërmojmë rrugën në shpatin matanë duke e ulur rrugën ekzistuese në 6 metra thellsi për të dalë në kuotën zero tek rruga ekzistuese. Mbrëmja erdhi si pakujtuar në këtë luginë, puntorët po largoheshin drejt kantierit ku kalojnë një natë pas ditës së lodhshme në kushte optimale e zhurma e eskavatorëve pushoi. Bashkë me natën po vinte dhe i ftohti i madh në luginën e zhurmëshme gjatë ditës. U ndamë me Shabanin i cili shkoi bashkë me këto mjeshtra që qëndisin udhët të kalojë natën në kantier. Makina u nis drejt Tiranës. U nis për të ardhur përsëri kur makineria e rëndë do të fillojë të shpojë tej e tej Qafën e Buallit e kur traseja do të ulet poshtë luginës së Planit të Bardhë. Edhe ministri i transporteve Sokol Olldashi u shpreh se segmenti i parë

Bulqizë-Ura e Çerenecit do të përfundojë brenda vitit 2009. Po kështu sipas tij edhe segmentet Bulqizë-Klos dhe Klos-Shkalla e Tujanit do të përfundojnë brenda vitit 2009. Le të shpresojmë dhe ne

-Atëherë rruga do të fillojë në të dy krahët, thotë Naimi. Edhe drejt Tiranës duke shpuar malet me tunele, edhe drejt Gjoricës ku përsëri kjo fushë do të gjëmojë nga plasja e shpesht e eksplozivit të rrugës si dukur para 160 vjetësh nga lufta e maleve të Dibrës kundër Hajredin Pashës. Por sot jetojmë në një realitet krejt ndryshe. Rruga e Arbërit do të bashkojë lindjen me perëndimin dhe nuk do ta ndajë Shqipërinë në copa siç ëndërronin dikur....

Gurët e Skëndërbeut mes historisë dhe legjendave

Në Bulqizë ka mjaftë maje malesh, mjaft maje shkëmbenjësh të lartë.
Në gjitha kanë nga një histori, kanë gojëdhënat e tyre, kanë dhe legjenda por mes tyre ka dhe të vërteta. E vërtetë është se pikërisht në këtë luginë është zhvilluar beteja e Vajkalit kundër ushtrisë turke të udhëhequr nga renegati Ballaban Pashë Badera. Kjo luginë u flet sot brezave të rinj për heroizmat e kryetrimit Gjergj Kastrioti Skëndërbeu.



Ashtu siç flet historia për heroin tonë kombëtar, për bëmat dhe heroizmat e tij kjo luginë është e mbushur edhe me mjaft legjenda e Naimi si i dhënë pas tyre nis e tregon:

-Ja gurët e Skëndërbeut ku maja që këtu poshtë nuk duket. Kur i shikon këto maje shkëmbenjësh sot të duken të vështirë e të pabesueshëm se do të jenë ngjitur dikur njerëzit lart. Traseja e rrugës së Arbërit u kalon fare pranë këtyre shkëmbinjëve, rruga është zgjeruar falë eksplozivit por maja e këtij shkëmbi të lartë as që do të ia dijë për këto gjëmime minash dhe zhurmë eskavatorësh. Të vetmit që dihen nga historia, nga gojëdhënat por dhe nga legjendat se kanë qenë zotër të këtyre majave të larta është vetëm Skëndërbeu me ushtrinë e tij. Sa gojëdhëna e legjenda thuhen për këto gurë të që vetëm kur hedh vështrimin nga poshtë të duken të papushtueshëm.

Thonë se Skëndërbeu në majën e këtyre gurëve kishte kalanë e tij dhe rrinte shpesh bashkë me ushtarët në majën e shkëmbenjëve. Turqit njëherë poshtë e rrethuan me qëllim që të dorëzohej pa kushte. Rrethimi qëndroi gjatë dhe pretendonin turqit se rezervat ushqimore ishin në mbarim e sipër dhe këto do të ndikonin që Skëndërbeu do të dorëzohej. E pikërisht në këtë kohë u përdor dredhia e famshme që dha rezultat por që u fut në legjendë. Skëndërbeu mori një pelë të madhe që përdorte për ushtrinë e tij dhe pasi e ushqeu disa dit me radhë me grurë, i vuri një përkrenare me brirët e dhisë dhe e hodhi poshtë greminës. Turqit kur e panë duke rënë poshtë u habitën dhe mendonin se çfarë të jetë pelë apo dhi. Kur ra poshtë dhe u ça më dysh panë se në barkun e saj kishte shumë grurë.

Besuan tamam turqit se Skëndërbeu ka mjaft rezerva ushqimore përderisa ushqen dhe kafshët. Për to rrethimi mund të mbante gjatë dhe do ti zinte dimri i ftohtë në këto anë pa ia arritur qëllimit. Kështu e hapën rrethimin dhe u larguan. Ikën turqit por ama i mbeti emri dhe fshatit Peladhi që sot shtrihet përgjatë luginës që nga Ura e Qytetit e deri në Krajkë.

"Bulevard i "Iliria" është i gjatë 520 metra dhe ka katër korsi dhe dy unaza qarkore. Është parashikuar të kushtojë afër 800 mijë euro, mirëpo kostoja e ndërtimit të kësaj rruge do të jetë më e vogël"


Rruga Dibër e Madhe - Zhirovnicë

Rruga Dibër e Madhe - Zhirovnicë me rrëshqitje gurësh

Segmenti rrugor 24 kilometra Dibër e Madhe -Zhirovnicë në drejtim të Shkupit dhe segmenti rrugor identik Dibër-Glloboçicë në drejtim të Strugës, ishin të vetmet segmente rrugore në Maqedoni me gjerësi të rrugës 5 metra, që pasqyronin egërsinë e ish sistemit monist ndaj Dibrës.

Segmenti rrugor Dibër e Madhe -Zhirovnicë i ngushtë, plot gropa dhe pa rrjeta çeliku në shkëmbejtë anësorë, përbënte rrezik të madh për lëvizjen e automjeteve.

Pas dy vite punimesh, në shtator të këtij viti, Mile Janakievski, ministri I Transporteve dhe Lidhjeve dhe Gordana Jankullovska,ministre e Punëve të Brendshme, përuruan dhe lëshuan në përdorim këtë segment rrugor të zgjeruar dhe të asfaltuar, edhe pse në shumë vende pa bankina dhe pa asnjë rrjetë çeliku për të mbajtur sadopak rrëshqitjen e dherave dhe gurëve anësorë.

Shirat rrebesh kohëve të fundit bënë që në afërsi të fshatit Skudrinjë dhe në afërsi të fshatit Rostushë, të shkatohen rreshqitje të dherave dhe gurëve në rrugën e re e të asfaltuar.Këto vende janë të pambrojtura dhe habit fakti se si projektuesit, inxhinierët e ndërtimit dhe mbikqyrësit e punimeve, kanë lejuar që në këto dy kthesa rruga të ndërtohet në shpinë të kodrave edhe pse ka patur mundësi që tu largohen kodrave.

Si do që të jetë vendosja e bankinave për gjatë tërë trasesë, vendosja e rrjetave të çelikut në vendet ku rreshqasin dhe zhvendosja e rrugës te kthesa e fshatit Skudrinjë që rrëshqet, duhej të ishin bërë para përurimit, ose duhet korrigjuar edhe tani për të thënë se rruga ka përfunduar dhe për tu shmangur nga rreziqet që kanosen.

R.TORTE

Dibër e Madhe, bulevardi "Iliria" në përfundim e sipër

Për herë të parë në historinë e saj në Dibër të Madhe po ndërtohet Bulevardi "Iliria" me dy unaza qarkore që ia shton bukurinë qytetit dhe lehtëson trafikun e automjeteve.

Argëtim Fida, kryetar I komunës lidhur me ndërtimin e këtij bulevardi shprehet se komuna e Dibrës së Madhe në vitin 2007 dhe 2008 me buxhetin e saj vazhdoi kryerjen e punimeve në Bulevardin "Iliria", në asfaltimin dhe në gjelbrimin në pjesën e mesit të kësaj rruge dhe në mblelljen e drurëve dekorativë në dy anët e trotuarëve përbri këtij bulevardi.

Duke folur për financimin e kësaj rruge, ai shton se, " kjo rrugë është rajonale dhe duhej të investohej me mjetet e Fondit për rrugët rajonale e magjistrale.Ne si BDI dy vitet e kaluara ishim në opozitë dhe nuk na akordoheshin mjete nga Qeveria, megjithatë ne si pushtet vendor nuk mund ta linim trasenë e rrugës ashtu të hapur veç me tampon, prandaj u detyruam t'I vazhdojmë punimet.Tani me që jemi pjesë e pushtetit qëndror jemi duke kërkuar nga Qeveria që shtresa e dytë e asfaltit të bëhet me mjete të Fondit për rrugë rajonale e magjistrale, ndërsa komuna vitin e ardhshëm do t'i përfundojë punimet e trotuarave dhe gjelbrimet anësore me mjetet që do t'i planifikojmë në buxhetin për vitin 2009", tha Fida.


Bulevardi "Iliria"

I pytetur për punimet që janë kryer deritani, ai thekson se:"Projekti i Bulevardit "Iliria" ngërthen në vete edhe shumë projekte tjera.Dislokimin e varrezave, hapjen e trasesë së rrugës, gërmimet ku u zhvendosën 24 mijë metra kub dhera ,mbushjen me tampon rreth 18 mijë metër kub tampon, vendosjen e bardurave, kanalizimin armosferik, kanalizimin fekal, elektrifikimin e bulevardit, gjelbrimin me afër 1 kilometër mure mbajtës, shtruarjen e 4500 metra kub truall cilësor, vendosja e rreth një kilometër e gjysëm tubacione dhe sistemin e I ujitjes, mbjelljen e drunjve dekorativë, ndërtimin e trotuarëve dhe dhe asfaltimin. Të gjitha këto projekte janë realizuar me përjashtim të shtresës së dytë të asfaltit prej 8200 metra katrorë që do të kushtojë afër 90 mijë euro,pllakëzimet e trotuareve që do të kushtojnë afër 120 mijë euro, dhe rregullimin e gjelbrimeve anësore që do të kushtojnë afër 20 mijë euro.

Ky bulevard është i gjatë 520 metra dhe ka katër korsi dhe dy unaza qarkore.Është parashikuar të kushtojë afër 800 mijë euro, mirëpo me që ne kemi punuar me nikoqirllëk dhe shumë punë i kemi kryer me punëtoprët tanë, kostoja e ndërtimit të kësaj rruge do të jetë më e vogël, tha në fund kryetari Argëtim Fida.

R.TORTE

SATIRE - *Nga* **Gazmend Kërkuti**

Dordoleci, kandidat për kryetar

INTERVISTA ME DORDOLECIN

Dordolec, çfarë të shtyu që të bëhesh kryetar?

Si fillim, faleminderit për intervistën! ... Arsyeja që unë tani kërkoj të bëhem kryetar është sepse tani është koha, tani ka dollarë të bëhesh kryetar i Dibrës.

Ato ish kryetarë, që kanë qenë në dekadën e kaluar nuk kanë pasur shumë mundësi të pasurohen. Tani që luftërat mbaruan, Maqedonia është qetësuar, Shqipëria po përparon, Rruga e Arbërit po afrohet... Dibra do të jetë udhëkryq dhe shumë dollarë do të shkrihen këtu, lumi unë!

Dordolec, si do t'ia arrish qëllimit të bëhesh kryetar? Ti s'je as familjar, s'ke asnjë pasuri, je pa shkollë... Si mendon të zgjidhesh?

Dëgjo me Lecin! Elita e Dibrës ka ikur me kohë nga Dibra. Shumica e njerëzve në Dibër tani janë "pleq", të cilët me një të pame "i ngri" dhe ua marr votën, pjesa tjetër janë fëmijë... ndërsa pjesa kryesore janë të koncentruar në sportçka dhe xhola... Kështu që, derisa të mbarojë loja, unë jam bërë kryetar. Haaa!!!

Nuk ke frikë që një ditë edhe mund të gjykohesh nga korrupsioni që bën?

Gjykohem???... Përkundrazi. Këtu në Dibër, ai që vjedh, pret, torturon pleq dhe fëmijë, respektohet më shumë. Nuk ka policë, si në kohën e ish-Jugosllavisë, kur dy policë mbanin qetësi. Tani ne njihemi njëri me tjetrin dhe, nëse ti s'je i fortë fizikisht, nuk e njeh ***X*** apo ***Y***, të mori lumi. Pastaj, unë e kam të vështirë nëse nuk vjedh, njerëzit do më thërrasin: *"Ja, ky budallai, që nuk vodhi!"* Më kupton Meni?



Po për kurbetqarët dibranë, çfarë premton të bësh, a ke në plan të hapësh punë që, ndoshta, edhe një ditë do të kthehemi ose të paktën t'i ndalësh ato të rinj që të mos ikin nga Dibra?

Kurbetqarëve dibranë që vizitojnë Dibrën për të kaluar pushimet në liqenin tonë të bukur *(se tjetër gjë nuk bëni)* ju premtoj, që tek liqeni, do të ndërtoj një WC për gra dhe fëmijë, ndërsa burrat do vazhdojnë të përdorin ferrat, prapa makinave, në liqen, etj) Aq mundem, besom Lecit!... Sepse më duhen paratë për banesën time në Durrës. Sa për punë, po kam në plan të hap edhe 5 minikazino që njerëzit të luajnë bixhoz, 9 xholanë për mësuesit dhe 10 internet kafe që fëmijët të shikojnë filma porno pa kufi.

(Ty Meni, asht majr të mos ma botosh këtë artikull, sepse na ban problem, kupton me Lecin. Sun vjedhim rehat! Ma mirë, dëgjomë mu, është mirë të shkrush artikull për Big Brother, Kafazi i Artë dhe i Ndrajshkun, Interin, Milanon. Ej, nigjo, mos i baj gjith vetë, kopjo ndonjë gjë në internet, si i thue taj, wbfaqe tjetër, e ke ma lehtë. Lena rehat të vjedhim! Dhe po vodha unë, do të kem parasysh edhe për ty ndonjë kockë!)

BIOGRAFIA E DORDOLECIT

Dordoleci është një njeri i ftohtë, vjen nga një familje e ftohtë, shkollën fillore dhe të mesme e ka kryer në mal, ku është shumë ftohtë dhe akulli shkrin vonë në pranverë.

Dordoleci nuk ka ndonjë biografi të pasur, del në skenë vetëm kur është ftohtë, por zhduket menjëherë sapo fillon e ngrohet.

Dordoleci që në fëmijëri ka qenë "dembel", por me ndihmën e disa dordoleceve të tjerë arriti të martohet me dordolecen, të cilën e tradhton dhe e maltrajton çdo sezon. Dordoleci ka në plan që, sapo të bëhet kryetar i Dibrës, të bëhet dordolec familjar dhe do t'i lërë njëherë e përgjithmonë bixhozin dhe alkoolin... për t'iu kushtuar më shumë kohë fëmijëve.

DEKLARIMI I PASURISË:

Dordoleci nuk ka pasur pasuri për të deklaruar, para se të bëhet kryetar. Ai do të deklarojë pasurinë vetëm pasi të bëhet kryetar. Për momentin, pasuria e tij është një kapele dhe një kravatë, sa për të treguar që është Dordolec zotni.

Dordoleci nuk ka punuar në jetën e vet, çdo herë me një vend ka ndenjur. Tani ka në plan të bëhet kryetar dhe do të punojë shumë fort për ta rregulluar Dibrën.

PREMTIMET:

Dordoleci nuk ka planprogram për të paraqitur para gjithë ne të tjerëve, që ta analizojmë para se ta votojmë. Ai nuk ka vizion dhe mos e pyet dy herë... mos hash ndonjë top dëbore!

Thjesht, Lecit i është paraqitur në ëndërr dëshira për t'u bërë kryetar, dhe tani këmbëngul ta bëjë realitet.

"Më duhen para", - thotë Leci!. Më kuptoni!"

Dordoleci premton, që, nëse bëhet kryetar, ai brenda 4 viteve do të ketë shtëpinë e vet karabina, disa dyqane nëpër qytet, *sanke* të re dhe nëse ngelet diçka, do blejë banesë në Durrës apo Sarandë, për t'u shkrirë.

Thjesht i duhen para Lecit dhe është i sigurt, që, nëse bëhet kryetar, do t'ia arrijë qëllimit të lartpërmendur. Nuk din të dallojë *e-mail* nga *wbfaqja*, *(më duhen orë për t'i shpjeguar ndryshimin)*, kështu që ju 114 wbfaqet dibrane mos pritni ndonjë raport në PDF, që të analizojmë se çfarë ndryshimi do të sjellë Dordoleci, por vazhdoni shkruani për Adelina Ismajlin apo për homoseksualët shtatzënë... Ato artikuj kërkohen nga Dordolecët e tjerë dibranë.

opinion

Mendime të një gazetari dibran në mërgim: Më në fund Dibra do ta ketë "Skënderbeun e vet". Kjo, falë skulptorit Sadik Spahia dhe biznesmenit Zaim Krosi. Ata duhet të shpallen "Qytetar Nderi" me një motivacion të thjeshtë: "Sollën Skënderbeun në Dibër".

KTHIMI I GJERGJ GJON KASTRIOTIT NË VENDLINDJE



Nga **ABDURAHIM ASHIKU**


Më në fund edhe Dibra do ta ketë "Skënderbeun e vet". Kjo, siç mësova nëpërmjet gazetës "Rruga e Arbrit", falë skulptorit Sadik Spahia dhe biznesmenit Zaim Krosi. Nuk e di nga janë dhe as e di në se i kam takuar ndonjëherë, por vetëm për kaq ata duhet të shpallen "Qytetar Nderi" të Dibrës me një motivacion të thjeshtë: **"Sollën Skënderbeun në Dibër".**

Por unë, nisur nga ajo që shkruhet: ***"Shtatorja 3.3 metra e lartë, do të vendoset mbi një piedestal 1.5 metra para Pallatit të Kulturës në Peshkopi në pranverë"*** mendoj që në Dibër të mos sjellim "Skënderbeun" por Gjergj Gjon Kastriotin, ta sjellim atë jo në Peshkopi por në vendin ku lindi dhe u rrit si Gjergji i biri i Gjonit dhe luftoi si Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.

Ndaj Gjergj Kastriotit, kohët e fundit është drejtuar tehu i mprehtë i shpatës së kundërshtarëve të tij shekullorë, të atyre që e duan "ndryshe", e duan "të tyren" si hero, si Georgi apo si Jorgo, si serb apo grek (po përcjell edhe një fotopikturë me diçiturë në greqisht), apo duan ta damkojnë si "tradhtar të Islamit". Së fundi, paqenësinë e tij si shqiptar dhe si hero i madh kombëtar i shqiptarëve po mundohen ta sulmojnë nëpërmjet babait, Gjon Kastriotit, duke e quajtur atë Ivan apo dreqi e di se çfarë u thotë leksikoni i gjuhës së tyre.

Gjon Kastrioti, Gjon Dibrani, siç e quan R. Voltarrano, tashmë nuk diskutohet se është dibran. . ***" Fakti që në Sinë të Dibrës, shkruan Kristo Frashri, historian i madh, biograf i Gjergj Gjon Kastriotit – Skënderbeut, dy orë larg fshatit Kastriot, i cili ndodhet po ashtu, siç shënon kronika e Lukarit, pranë lumit Drin, tre ose katër breza pas Pal Kastriotit, ekzistonte një familje me të njëjtin mbiemër, siç është ajo e Dhimitër Kastriotit, kjo nuk është e rastit. Kjo tregon se Kastriotët ishin vendosur prej kohësh në fshatin Sinë".***

Por edhe pse ishin në fshatin Sinë Kastriotët pronat e tyre i kishin poshtë në fushë. Në mes të kësaj fushe ndodhet fshati Kastriot. Pikërisht në disa pika të caktuara të këtij fshati, një varg i tërë toponimesh janë të lidhura me emrin e babait të Skënderbeut, siç janë Kulla e Gjonit, Kopshti i Gjonit, Pusi i Gjonit, Ograja e Gjonit... ***Të gjitha këto të dhëna***, përfundon Kristo Frashëri, ***mbështetin traditën popullore dibrane, sipas së cilës Skënderbeu lindi në Shëgjerth (lagje e Sinës) dhe u rrit në Çelias (lagje e Kastriotit).***



Lugina e Drinit të zi. Pamje nga Suka e Arrasit. Foto arkiv e autorit

Nuk ka pse të citoj Hazis Ndreun dhe Ali Hoxhën që patën meritën e madhe që nëpërmjet toponimisë të sjellin në vëmendje të historianëve fakte se Gjergj Kastrioti "lindi në Shëgjerth (lagje e Sinës) dhe u rrit në Çelias (lagje e Kastriotit)" dhe se beteja e parë dhe fitorja e parë me rëndësi evropiane – afrikane - aziatike (bota e asaj kohe) mbi hordhinë osmane, u shënua në vendlindjen e tij.

Nisur nga fakti tashmë i pakontestueshëm se Gjergj Kastrioti lindi në Sinë të Dibrës, u rrit në Kastriot, u kthye në Shqipëri në Dibër, mori besën dibrane në "Kuvendin e Dibrës", zgjodhi Dibrën për betejën e parë dhe për 17 nga 24 betejat e tij fitimtare mbi hordhinë më të madhe të kohës, si dhe të tjera vlera të Tij, mendimi im është që përmendorja në fjalë të vendoset në VENDLINDJE.

Gjergj Kastrioti ishte njeri i lirë. Ai, në tërë betejat e tij, nuk u mbyll kurrë në ndonjë kështjellë. Ta mbyllësh atë në një bulevard të vogël këmbësorësh, përpara një pallati kulture që mban emrin e "Haki Stërmillit", me vështrim mbi pullaze tjegullash pallatesh të vjetra dykatëshe në moshën për tu prishur, mendoj se është gabim dhe duhet parë.

Po ku duhet të vendoset monumenti i bronztë i Gjergj Gjon Kastriotit?

Përvoja e dymbëdhjetë viteve emigracion më ka mësuar se kujtesat e mëdha të një kombi asnjëherë nuk janë mbyllur mjediseve të vogla. Ata janë vendosur në pika të larta ku heronjtë "shohin" larg dhe ku njerëzit i shohin nga larg, me dëshirën e madhe tu afrohen, madje edhe të kalojnë çaste të bukura çlodhje shpirtërore e kujtese historike. Ata janë vendosur ose në vendlindjen e tyre ose në vendet ku kanë bërë histori. Mendoj që edhe ne, në kushtet e hapjes me botën duhet të hapemi.

Statuja e madhe e Skënderbeut duhet të vendoset në një vend që bota ta shohë edhe nëpërmjet sistemit satelitor, në një vend që të dominojë vendlindjen dhe fushëbetejat e tij. Po cili është ky vend?

Mendimi im është që Gjergj Gjon Kastrioti të vendoset në Sukë të Arrasit, në atë kodër që i qëndron gjithë luginës së Dibrës si far. Aty, Gjergj Gjon Kastrioti - Skënderbeu duhet të vendoset në atë mënyrë që djathtas të ketë "Shëgjethin", majtas "Çelinë" poshtë "Fushën e Torviollit" dhe përpara Dibrën mbarë. Ai duhet ta vështrojë Lindjen si sfidë që i bëri asaj në të gjitha betejat. Pas ai duhet të ketë Malet e Dibrës, ato male që iu bënë mburojë e që luftuan deri në fëmijën e fundit pas vdekjes së tij, Çidhnën...



Fotopiktura që paraqes është marrë nga një kalendar grek. Në të shkruhet: "Jorgos Kastriotis (pikturë e Konstantin Potamjanit). 17-I-1467 Vdekja e Kastriotit – Skënderbej. Historia e Epirotasit Grek Jorgji Kastrioti është epike

Piedestali i lartë dhe mjedisi rreth e qark krijojnë mundësinë e "shkrimeve" të tjera në art për bëmat e mëvonshme të dibranëve si "Kuvendi i Arrasit" dhe ngjarje të tjera të shumta historike të zonave për rreth. Një kompleks turistik, një restorant me ballkone që shohin malet me Korabin në krye dhe luginën e Drinit në të dy krahët, një restorant me "Troftë Sete", pse jo edhe një qendër administrative e komunës me një muze që mund të "shpërngulet" nga Sina, do të përbënin perlën turistike të historisë së Dibrës.

Më ka ndodhur që në vitet tetëdhjetë të jem ciceron i një grupi gazetarësh të huaj në udhëtimin e tyre tek Liqenet e Lurës, Kanali i Setës etj. Në Qafë të Arrasit kërkova të ndalojë autobusi i vogël turistik. I udhëhoqa gazetarët në shkallët e sajuara drejt majës, midis dy rreshtave të ngarkuar me kumbulla të pjekura, drejt Sukës së Arrasit. U befasuan nga pamja mbrëmësore me Drinin nën këmbë e Korabin mbi krye. Por, kur u tregova për Gjergj Kastriotin – Skënderbeun, vendlindjen dhe vendluftimet e tij fitimtare, kur për një çast i ktheva pesë shekuj më pas duke u thënë që t'i përfytyronin radhët e mollëve të Kastriotit dhe Ostushit dhe radhët e kumbullave të Shumbatit, si ushtarë në betejën e parë të Skënderbeut dhe në fitoren e parë historike të botës së asaj kohe mbi hordhinë osmane, befasia e tyre arriti kulmin. Aty, për të dytën herë atë ditë, pas pamjes së bukur tek Liqeni i Madh, pash një njeri të ulet në gjunjë e të lutet si para Zotit...

Vendosja e monumentit të Gjergj Gjon Kastriotit mbi Sukë të Arrasit mendoj se duhet parë edhe në një tjetër këndvështrim.

Dibra ka një festë të vetën, një festë popullore me rrënjë pagane. Ajo festë ka emrin e Gjergjit, "Shën Gjergji". Festohet gjithnjë më 6 maj.

A nuk do të ishte bukur që kjo festë të shpallej si "Festë Popullore e Dibrës" ashtu siç tashmë është shpallur (edhe si festë zyrtare) "Dita e Verës e Elbasanit"?

Vendi, por edhe pozicioni gjeografik, lejon veprimtari të bukura në natyrë. Lejon që aty të zhvillohet një garë e bukur blegtorale se kush do të sillte në konkurs "qengjin apo kecin më të madh", një festival këngësh për pranverën nga fondi shumë i pasur folklorik i zonës, që nga Lura, Selishta e deri në Reç e Kala të Dodës.

Gjergji i Gjon Kastriotit, Skënderbeu nuk duhet të "burgoset" në një bulevard të vogël, nuk duhet të "fshihen" pas degëve të blirit. Gjergj Kastrioti nuk e ka njohur kurrë as "burgun" e as "fshehjen". Nuk e ka njohur i gjallë, nuk duhet ta njohë edhe si statujë. Ai duhet të vendoset atje ku i bën nder Dibrës dhe tërë Shqipërisë, në vendlindjen dhe fushëbetejën e tij të madhe.

Dikush do të thotë se është larg. Unë, nisur nga hapësirat që përshkoj në fundjavë për një "kafe" apo për një "drekë", them se është shumë afër, vetëm 20 kilometra nga Peshkopia dhe 100 kilometra (kur të bëhet Rruga e Arbrit) nga Tirana. E çfarë janë 100 kilometra me infrastrukturën që do të krijohet detyrimisht edhe në Dibër për të pirë një kafe apo për të ngrënë një drekë me "troftë të pjekur në prush" në atë vend zanash për nga bukuria dhe të vetmin për nga historia?

Ndokush do të thotë se Fusha e Çidhnës, Kastrioti, "Çelia" dhe tërë lugina e Drinit nga Reçi në Gjoricë do të mbytet. Unë e kam thënë fjalën time për këtë dhe pres që ta thonë tërë dibranët. Por, edhe sikur kokëfortësia e shtetit ta mbysë Dibrën, vendlindjen dhe vendbetejat e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, monumenti i Gjergj Gjon Kastriotit atje e ka vendin, si një FAR – drite, nder për Dibrën dhe tërë Shqipërinë.

Ky ishte një mendim imi, mendim që e ve në debat me historianë, njerëz të artit dhe të kulturës, me Sadik Spahinë, Zaim Krosin, Naim Plakun, Qerim Sulën, Përparim Tomçinin, Ali Hoxhën, Adem Bungurin, Luan Kabën, Xhaferr Martinit, Moisi Murrën, Hajri Shehun, Bajram Krrashin dhe të tjerë që për momentin nuk i sjell dot emrat në kujtesë.

E ve në diskutim edhe me njerëz që kanë pushtet, pushtet të votës së popullit apo të emëruar; me kryetarin e bashkisë së Peshkopisë z. Krosi, kryetarin e komunës së Arrasit, kryetarin e komunës së Fushë – Çidhnës, prefektin e Dibrës z. Seiti, sekretarin e prefekturës z. Begu, deputetët e zonës dhe të tjerë.

Për Gjergjin e Gjon Kastriotit, për përmendoren e Tij, duhet të vendosin intelektualët dhe jo pushtetarët.

Unë e thashë mendimin tim, edhe pse e di se do të përballet me heshtje ashtu siç po përballet edhe mendimi për t'i thënë ndal "Mbytjes së Dibrës".

E shkruara mbetet...

** Dibran, emigrant në Greqi.*

Kojnara, fshat i bukur por i braktisur që gjendet buzë lumit Drini i Zi dhe përbri kufirit me Shqipërinë.

FSHATI KOJNARË
me perspektivë të shkëlqyer



Pamje e fushës së Kojnarës

Nga **REXHEP TORTE**

Këtyre ditëve të dhjetorit të shoqëruar nga Nuredin Beqiri, kryeplaku 78 vjeçar i fshatit dhe nipi i tij Sekim Beqiri, vizituam fshatin Kojnarë, fshat tejet të bukur por i braktisur që gjendet buzë lumit Drini i Zi dhe përbri kufirit me Shqipërinë.

Siç më informuan këta shoqërues, ish banorë të fshatit Kojnarë, ky është fshati më i gjerë në Komunën e Dibrës së Madhe. Sinuret e këtij fshati shtrihen nga periferia e Dibrës së Madhe, te fshatrat Bohmovë, Shushicë, Shullan e gjer në Gjoricë të Shqipërisë dhe se asfaltimi i rrugës hap perspektivën e shkelqyer të zhvillimit. Ne jetojmë në qytet por shpirtin e kemi në Kojnarë u shprehën shoqëruesit e mij Nuredin dhe Selim Beqiri.

FSHAT ME BUKURI MAHNITËSE

Rruga nga Dibra e Madhe për në fshatin Kojnarë kalon nëpër luginën e quajtur Sitnicë dhe pasi arrin Kodrën e Kuqe lëshohesh teposhtëzës që të çon drejt fshatit. Ky fshat ka qindra hektarë tokë bujqësore, livadhe dhe qindra hektarë zabele frutore dhe drusore të shoqëruara me burime të ujit pastër e të ftohtë. Ky fshat në lulzimin e tij ka patur 75 shtëpi. Në dy anët e rrugës dhe nëpër kodra të bijnë në sy shumë shtëpi që i sfidojnë kohës, por edhe shtëpi të shkatërruara. Ky fshat ka patur shkollën dhe xhaminë e tij. Në këtë fshat aktualisht nuk banon asnjë familje. Ajo që të mahnit duke shëtitur nëpër këtë fshat është infrastruktura e tij e dikurshme, rrugët dhe oborret e shtëpive të shtruara me kadërme, çezmet dhe burimet e shumta të ujit.



Kosheret me bletë në Kojnarë



Kryeplaku Nuredin Beqiri me shpirt te Kojnara



Shtëpi të braktisura në Kojnarë

THEMELUESIT E FSHATIT JANË NGA SHQIPËRIA

Ky fshat ka historikun e tij shekullor. Familjet e para të këtij fshati kanë ardhur nga zonat e Shqipërisë së sotme dhe janë vendosur në këtë fshat me lugina dhe kodra që nuk i vret era. Këtu kanë jetuar dhe kanë pasuritë e tyre të patundshme familjet Koxha, Strikçani, Beqiri, Fida, Delishi, Lela, Kaja, Bajro etj.

Dr. Liri Delishi, tregon se sipas të dhënave statistikore ky fshat ka 619 hektarë tokë. Prej tyre 197 hektarë tokë pjellore të kategorisë së parë, 7 hektarë tokë për perimekulturë, 60 hektarë toke forgjere, 106 hektarë zabele me dru gënjtenje, 4 hektarë vreshta, 20 hektarë livadhe, 123 hektarë kullota, 159 hektarë zabele drusore dhe 27 hektarë tokë joproduktive etj. Ajo që e dallon këtë fshat është prodhimi sasior dhe cilësor i gështenjave prej afro 200 tonelatash në vit , pastaj i drithërave, misrrit, fasules dhe perimeve. Për shkak të kullosave të begata në këtë fshat ka qenë e zhvilluar shumë edhe blektoria.

FSHATI DO TË LIDHET ME RRUGËN E ARBËRIT

Zbrazja e banorëve të fshatit Kojnarë filloi viteve të shtatëdhjeta, e para për arsye të paraqitjes së ujërave nëntokësore pas mbushjes me ujë të Liqenit artificial të Dibrës së Madhe në vitin 1969 dhe rrëshqitjes së tokës, dhe e dyta për arsye ekonomike, të rënies së zhvillimit bujqësor, dhunës policore, papunësisë dhe shpërnguljes në qytet dhe mërgimit jashtë vendit.

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës, lidhur me ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës së fshatit Kojnarë, thotë se:"Qysh në vitin 2005 pushteti vendor përgatiti një projekt cilësor për asfaltimin e rrugës së këtij fshati. Me aksionet e vetë banorëve të këtij fshati kemi zgjeruar rrugën në tetë metra gjerësi në tërë gjatësinë e saj prej 3 kilometra e tre qind metra. Me këtë projekt aplikuam te Banka Botërore dhe atje u vlerësua si njëri nga projektet më të mira në Maqedoni. Tani jemi në pritje që sa më shpejt të bëhet tenderimi, realizimi dhe mbikëqyrja e punimeve nga Banka Botërore. Mbesim në shpresë që edhe komunat e tjera që aplikuan të bëjnë korrigjimet e rekomanduara në projektet e tyre sa më shpejt që në janar të vitit 2009 të përfundojë procedura e denderimit dhe punimet të fillojnë në pranverë.

Kjo rrugë do të lidhet me fshatin Gjoricë të Shqipërisë që llogaritet si pika nga ku do të kalojë edhe Rruga e Arbërit për Maqedoni.

KOJNARA SHPRESON NË RINGJALLJE TË PLOTË

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës do ta rringjall këtë fshat të begatë, sepse tashmë shumë banorë të këtij fshati kanë filluar të ndërtojnë shtëpi vikendi, kanë ngritur dhe sistemuar zgjojet e tyre me bletë , stallat me bagëti dhe kanë intensifikuar punimin e tokave pjellore bujqësore, përbri të cilave rrjedhin burimet ujore të pashterrshme dhe kanë përtrirë bahçet me perime e pemë frutore.

Ndërtimi dhe asfaltimi i kësaj rruge do të mundësojë arritje më të lehtë dhe më të shpejtë te të gjitha tokat e punueshme, punimin më efektiv të këtyre tokave dhe vjeljen dhe sjelljen në shtëpi të prodhimeve bujqësore që shquhen për nga cilësia dhe sasia.

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për të arritur në këtë fshat të bukur me plot resurse bujqësore dhe turistike, me siguri do të sjell gjallërimin e këtij fshati.



Rruga kryesore në fshatin Kojnarë

investime

Më datë 24 dhjetor 2008, firma "Korabi-Ready Mix" e biznesmenit dibranoamerikan Ibrahim Kolari, shënoi 5-Vjetorin e themelimit dhe të funksionimit të saj

Djersa për vendlindje më kënaq shpirtin



Për herë të parë në historinë e Di brës së Madhe, më datë 24 dhjetor 2008, Firma "Korabi-Ready Mix" e biznesmenit dibranoamerikan Ibrahim Kolari, shënoi 5-Vjetorin e themelimit dhe të funksionimit të saj, me një darkë solemne me prezentimin e sukseseve, fjalë miradie, muzikë dhe këngë e valle në praninë e qindra të ftuarve, në mesin e tyre përfaqësues të pushtetit vendor, të familjarëve, partive politike, të bashkësive fetare, biznesmenëve, partnerëve, intelektualëve, përfaqësuesve të arsimit, shëndetësisë, sportit, etj.

BIZNESMEN I SUKSESHËM DHE ATDHETAR

Ibrahim Kolari, biznesmeni dibrano-amerikan, është ivetmi që deri tani në vendlindje ka investuar më shumë se 2 milonë euro.

Ky biznesmen i sukseshshëm shquhet edhe edhe për aktivitetet si kryetar i Shoqatës Atdhetare Dibrane në Nju Jork, inicues i vëllazërimit të Dibrës me Staten Islanditn, aktivist i çështjes kombëtare që ka dhënë kontriburtin e tij në organizimin e demonstratave në SHBA, kontribues financiar i Luftërave të UÇK në Kosovë e Maqedoni, angazhues kryesor që eshtrat e Faik Konicës të kthehen në Shqipëri, sponsorizues i aktiviteteve kulturore e sportive, financues në ngritjen e objekteve kulturore e fetare dhe ndihmues financiare për familjet e varfëra në Dibër të Madhe.

e shpejtë do të ketë shumë investime.

Ajo që dëshiroj të theksoj është se në Maqedoni duhet luftuar korrupsioni, byrokracia dhe të zbatohet ligji. E tërë kjo do të krijojë klimë të përshtatshme për investime. Zoti e bekoftë SHBA-në për mundësinë dhe eksperiencën që na e dha. Zoti e bekoftë edhe populin shqiptar".

PUSHTETI VENDOR ME PROJEKTE PËR INVESTUESIT

Argëtim Fida, me këtë rast shtoi se:" Fillimisht uroj z. Ibrahim Kolari për rizgjedhjen e tij kryetar i SHAD në Nju Jork. Ibrahimi është bërë shembulli i parë pozitiv se si duhet vepruar biznesmenët e suksesshëm në SHBA, që pos aktiviteteve të atjeshme , dëshmojnë edhe lokalpatriotizmin, se dashuria për vendlindjen është obligim që edhe këtu të vazhdojnë me bizneset e tyre të investojnë për të ndërtuar Dibrën e Madhe. Ne si pushtet vendor u angazhuam katër vite radhazi që me projektet dhe planet e reja detale, me planin general urbanistik, të krijojmë zona ekonomike, të hapim fronte pune për të gjithë ata që do të kenë dëshirë të investojnë. Gjatë zgjerimit të segmentit rugor Dibër e Madhe-Zhirovnicë shumë aktivisht u angazhua edhe firma Korabi e z. Ibrahim Kolari. Kjo firmë dotë ketë shumë punë edhe në vitin

pos të punësuarve të vet ka angazhuar edhe 100 persona tjerë që merren me ndërtim, dhe pajisjen e brendshme e të jashtme të ndërtesave dhe kështu kanë siguruar ekzistencën e tyre. Për Dibrën e Madhe vijnë ditë më të mira dhe dëshiroj që shembulli i Ibrahim Kolarit t'i nxit edhe biznesmenët e tjerë që të vijnë të investojnë në vendlidje".

TRADITA AMERIKANE VJEN EDHE NË DIBËR TË MADHE

Bllagoja Spirovski, përfaqësues i eparhisë së Kishës Orthodokse, u shpreh se:"Net ë gjithë para Zotit jemi të njejtë, jemi fëmijët e Zotit. Që në takimin e parë me Ibrahim Kolarin, mësova se ka ide të mira, është energjik dhe ka dëshirë pozitive për vendlindjen. Ai ka dhunti për të bërë diçka të dobishme qoftë në SHBA, qoftë në vendlindje. Me djersën dhe angazhimin e tij kabërë gjëra të mrekullueshme. Zoti e bekoftë dhe ia shtoftë pasurinë".


Bashkësia lokale e fshatit Kosovrast e falenderoi Ibrahim Kolarin për kontributin e tij prej 20 mijë euro për ndërtimin e minares në xhaminë e re të fshatit.

Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës së Madhe, në fjalën e tij të rastit , theksoi se:"Për mua këto mbrëmje janë stimulative, sepse Ibrahimi me këtë manifestim të 5- Vjetorit të ndërmarrjes së vet, na e qetëson shpirtin të qëndrojmë këtu e të mos mendojmë

edhe ardhmëria, aty ndërtohet njëobjekt, një shtëpi, një shkollë, një xhami, një rrugë një infrastrukturë ku do të jetojmë ne dhe fëmijët tanë, ku do të jetojë populli. Besoj se edhe të tjerët do ta ndjekin këtë shembull, duke filluar nga investimet familjare

rezultatet rezultatet e arritura gjatë vitit dhe për të planifikuar një të ardhme edhe më të begatë. Ky solemnitet është edhe kominikues dhe komunikimi është instrumenti më i fuqishëm mes njerëzve. më i fuqishëm është komunikimi mes

NË MAQEDONIM TË LUFTOHEN KORRUPSIONI DHE BYROKRACIA





Ibrahim Kolari, president i firmës, duke përshëndetur të pranishmit deklaroi se:"Unë sonte para jush nuk do të lexoj fjalë të shkruara në letër, por do të flas atë që ndjej dhe që ma thotë zemra. Kjo firmë u themelua në vitin 2003. Asokohe dikush më thoshte ta blej këtë firmë shtetërore e dikush të mos e blej. Unë vendosa ta blej dhe të investoj në këtë firmë, i nisur nga dëshira për të investuar në vëndlindjen time. Por ja që nuk gabova dhe firma ime po punon me sukses. Unë këtë nuk e quaj sukses timin, ky është edhe sukses i juaji. Unë do ta quaja sukses edhe më të madh kur sipas shembullit tim në Dibër të Madhe të vijnë edhe investues të tjerë nga SHBA dhe diaspora. Unë gjithnjë e kam në mëndje investimin në vendlindje. Në takimet me senatorë dhe kongresmenë në SHBA më është thënë se perëndimi interesohet për Ballkanin dhe se këtu në të ardhmen

2009 në ndërtimin e mureve mbajtëse të pjeës së rrugës Ura e Boshkut-Dibër e Madhe. , pastaj do të fillohet edhe me ndërtimin e kapaciteteve zgjeruese të Kombinatit të Gjipsit "Knauf", ndërsa edhe me projektet që i ka planifikuar komuna me ndërtimin e palestrës sportive, me godinën e gjimnazit dhe me objektet e tjera. Dibranët nga SHBA-të kanë investuar këtu mbi dhjetë milionë euro, duke ble banesa, dhe kjo ndikon edhe në zhvillimin e ekonomisë së ndërtimit. Firma e Ibrahim Kolarit

të mërgojmë për në SHBA. Ky aktivitet është shembëlltyrë e një aktiviteti praktik që shkon në frymë e asaj që shumkush e çdokush sa e don vendlindjen aqë edhe investon në në vendlindje. Investimi tregon dashurinë e simpatinë ndaj vendlindjes. Kjo duhet të jetë shembëlltyrë edhe për të tjerët, veçanërisht për ata që mendjen e kanë te shpërngulja që shpërnguljen ta harrojnë përgjithmonë. Aktiviteti praktik i kësaj ndërmarrje ka edhe një simbolikë tjetër, që na mbush plot shpresë, sepse aty ku hudhen gurthemelet aty është

të tyre, sepse Dibra e Madhe frymonn falë investimeve nga SHBA, por tani këto investime duhet të jenë shumë më të mëdha. Ju të pranishëm jeni bartës së ekonomisë dibrane dhe ky është edhe një obligim moral për të gjithë ne për të bashkëpunuar, për tu respektuar dhe për të patur ndihmë të ndërsjellë në të gjitha sferat e jetës. Ky manifestim është edhe sjellje e kulturës së traditës perëndimore në Dibër të Madhe, sepse në SHBA nq fundvit ëhet në fundvit firamat bëjnë kësi takimesh me partnerët, miqtë e shokër për të tu njohur me

njerëzve. Ku shtrohet buka është edhe bekimi i Perëndisë dhe Perëndia na bekoftë të gjithëve".

Gjenerali Gëzim Ostreni, para të pranishëmve foli fjalë miradie dhe e përgëzoi z. Ibrahim Kolari për angazhimin e tij, investimet në vendlindje dhe dhe për sukseset e arritura.

Me këtë rast Ibrahim Kolari dorëzoi mirënjohje për ndërmarrjet dhe individët me të cilët ka patur bashkëpunim më të suksesshëm.

R.TORTE

Kujtimet e një inxhinieri: Kur kërkonim minerale në malin e Korabit.
Pjesë nga libri i pabotuar i Vesel Hoxhës, "Shënime në Çadër"

Shqipëria është e vogël në hartë, inxhinier!



Nga **VESEL HOXHA***



Një grup specialistësh gjatë punimeve fushore në kërkimet gjeologjike

Pas mbrojtjes së diplomës fillova punë në Bulqizë. Të them të drejtën nuk ndjehesha mirë, jo se Bulqiza konsiderohej një qytet i vogël e i ftohtë e të tjera probleme, por nuk ndjeja shumë kënaqësi profesionale. Dijet e marra në shkollë ***sikur pykëzoheshin shumë shpejt*** në një drejtim jo shumë produktiv për moshën time të re të asaj kohe. Punën në zbulimin e mineraleve të dobishme në përgjithësi e kam parë si një punë që gjeologu duhet të merret pasi ka kaluar një pjesë të mirë të jetës së tij rinore në punime rilevuese gjeologjike, në ato të kërkimit e kërkim vlerësimit, pa hyrë në specializimet e ngushta që kërkon koha e puna e mirëfilltë shkencore për të pasur efektivitet.

Pavarësisht nga dëshirat e mia, u emërova të punoj në Ndërmarrjen Gjeologjike të Bulqizës, aty ku kisha bërë stazhin dhe plus do të ndiqja dhe punimet në **zonën "D"** të vendburimit të Bulqizës. Inxhinier të parë kisha Bashkim Lleshin. Nuk vonoi shumë dhe inxhinier Bashkimi u komandua kryegjeolog i ndërmarrjes, kësisoj mua më binte barra të ndjek shumicën e punimeve, ndonëse isha i ri dhe kisha fare pak eksperiencë për punimet e shpimit që kryheshin nga kamerat (dhomat) nëntokësore. Mundësia për të bërë gabim ishte shumë e madhe, pasi aty brenda nuk ke nga orientohesh. Ndonëse inxhinier Bashkimi u komandua në detyrën e kryegjeologut, për hir të së vërtetës duhet thënë se ai nuk e ndërpreu ndihmën, gjersa u bind se mund të punoja dhe i pavarur. Një prej atyre ditëve që vazhdonte duke më ndihmuar, ose me saktë duke më kaluar punimet në dorëzim, zhvillon me mua një bisedë. Sapo ishim futur në galerinë "C". Uji që kalonte nëpër galeri i afrohej majës së çizmeve. Në pamjen e parë ajo masë uji që lëvizte me një fështërimë të lehtë nëpër galeri të jepte një lloj frike. Herë pas here e pyesja inxhinier Bashkimin, nëse kishte ndonjë mënyrë për t'i larguar këto ujëra, për ta bërë më të lehtë e të sigurt kalimin e njerëzve, duke eliminuar ndonjë rrezik tjetër që mund të vinte nga kjo masë e madhe uji që kalonte pa ndërprerë mes për mes punimit minerar dhe nga çasti në çast mund të na i mbushte edhe çizmet tona plot e përplot. Po punohet për t'i disiplinuar këto ujëra dhe shumë shpejt galeria do të jetë e pastër, e mbylli shkurt përgjigjen për pyetjen qe i bëra. Vazhduam disa minuta në heshtje rrugën. Dëgjohej vetëm zhurma e çizmeve në ujë dhe ndjehej era ***jo e këndshme e acitelenit (C_2H_2) që çlirohej nga bashkëveprimi i karbitit (CaC_2) me ujin (H_2O), duke u djegur e duke na dhënë atë flakën e famshme që ndriçon në nëntokë,*** për të kryer punët. Në minierat metalifere përdoret ndriçim me llampa karbiti. Nuk vonoi shumë dhe heshtjen e prishi inxhinier Bashkimi. Më ke shprehur dëshirën se puna në zonën e Korabit të pëlqen më shumë se kjo që po bën aktualisht – filloi dialogun inxhinier Bashkimi.

- Po, - i përgjigjem me shpejtësi dhe me një habi të madhe. - Jo vetëm nga fakti se prindërit dhe familjen i kam andej, por më kryesorja se kam dëshirë të punoj në terren, për t'u dhënë jetë dijeve të fituara në shkollë. Vërtet në Bulqizë mund të bëj një jetë familjare më të stabilizuar, por – vazhdova bisedën unë - nuk mendoj se do të bëhem gjeolog në kuptimin e plotë të fjalës.

- Ndonëse jam i komanduar në detyrën e kryegjeologut – vazhdoi bisedën ai – unë do t'i propozoj drejtorit që ju të kaloni **në Ekspeditën e Peshkopisë**, dhe më konkretisht, në Zonën e Korabit, si zonë gjeografike dhe tektonike. Të them të drejtën ndjeva një gëzim të madh në zemër që rrallëherë përjetohen gjatë jetës. Për inxhinier Bashkimin edhe pse kisha njohje me të, çka i kam pasqyruar në tregime të tjera të këtij libri, tani m'u bë edhe më i afërt, edhe më i mirë. Atë ditë nuk e kuptova fare se si iku orari i punës, ndonëse për gjeologët orari është në rendin e dytë, kështu është natyra e punës, natyra e profesionit.

- Ju do vazhdoni punën këtu, derisa këto punë të marrin rrugë zyrtare, pasi, siç ju thashë, vendimin e merr drejtori.

Njerëzit seriozë i mendojnë thellë gjërat. Nuk vonoi më shumë se dy muaj dhe në prag të punimeve fushore të vitit 1976, unë transferohem në Ekspeditën e Peshkopisë, ndonëse inxhinier Bashkimi nuk ishte më në ndërmarrje. Ishte transferuar në një detyrë tjetër më të rëndësishme, por në ndërmarrje **ishte porosia e tij,** siç m'u shpreh **kryegjeologu i ri në detyrë, flokëbardhi ing. Sali Bushi,** të cilin gjithë jetën e ka karakterizuar ndershmëria dhe përkushtimi në punë. I aftë nga ana profesionale dhe i thjeshtë në komunikim me njerëzit.

- Ja pra - thashë me vete – nuk paska harruar inxhinier Bashkimi! Në këtë botë ka njerëz të drejtë e seriozë. Atë që thonë e bëjnë realitet. Ah sikur **– psherëtiva thellë -** të jenë të gjithë njerëzit të drejtë e korrektë, shoqëria njerëzore do të kursente shumë dhe jeta e njeriut do të ishte shumë më ndryshe.

* * *

Menjëherë paraqitem në punën e re dhe fillova të njihem me studimet e kryera më parë nëpërmjet raporteve gjeologjike që kisha marrë në arkivin e Bulqizës për zonën e Korabit, në kuptimin gjeografik dhe tektonik të fjalës, ashtu siç ma tha që në fillim ing. Bashkimi. Të them te drejtën, ndonëse jam nga ato anë, nuk e njihja pothuajse fare terrenin ku do të punoja dhe **ndjeja një farë frike**, vetëm i njihja si emra, të cilat i kisha mësuar në lëndën e Gjeografisë në shkollën 7– vjeçare të Fushë Alies, nga i ndjeri prof. Sabri Abdiu nga Sohodolli (Suhadolli). Pasi kryej përgatitjet e nevojshme, sipas rregullit, paraqitem në ndërmarrje në Bulqizë për të marrë materialet e nevojshme për punë. Hartova një listë dhe e dërgova disa ditë para në ndërmarrje që të mos kisha pengesa kur të veja për të bërë furnizimin, duke i dhënë mundësi Degës së Planit të kishte kohën e duhur në dispozicion për t'i bërë gati dhe, të merrte masat për ndonjë material që nuk e kishte në magazinë, **siç kishte dalë problemi i çadrave italiane dy dhe katër vendëshe,** të cilat ishin marrë nga magazina e një ekspedite në rrethin e Matit me urdhrin e kryegjeologut Bushi.

* * *

Po ashtu, kisha marrë masa për të gjetur një person me kafshe, i cili do të na furnizonte me ushqime e bazë materiale për punë here pas here. Ky ishte **Isuf Dobi** nga Fushë Muhurri. Rastësia e solli që të punonte me mua. Ishte vera e vitit 1976. Isufi nuk i kishte kaluar të dyzetat, por neve na dukej i madh në moshë nga që ishim të rinj dhe faktit që ai nuk kujdesej shumë për paraqitjen e jashtme, siç nuk kujdesen rëndom në përgjithësi fshatarët. Isufi nuk është shume i pashëm, por, pasi të njihesh me të, me sjelljen, punën dhe përkushtimin që ka, të duket i bukur. Isufi ishte pa ndonjë shkollë të madhe, por kur i thonë fjalës **"te jepte ujë në bisht të lugës"**, pasi jo vetëm ishte një njeri i mirë dhe kishte zgjuarsi natyrale, por në një farë mënyre ai e kishte mbaruar **Universitetin e Dibrës**, ndryshe nga unë që s'kisha haber nga ato gjëra. Shkurt, Isufi fliste me alegori dhe, duhej "**kujdes e kualifikim"** për t'i kuptuar të gjitha ato që thoshte. Këto gjëra i mësova shumë vonë tek Isufi. Nga libri **"Perlat e Dibrës" (**ribotim) i shkrimtarit e studiuesit të mirënjohur dibran Xhafer Martini, po shkëpus një prej atyre perlave, për ta ilustruar se si Isufi të binte **"me thupër"** gjatë bisedës:

"Kur kam qanë i ri, kam mbajtur ramazan. Punoja gjithë ditën dhe më hahej bukë. Iftarin, me thanë të drejtën, mezi e prisja, se ishte ditë e gjatë. Nuk më rrihej vendi më vend derisa të binte lodra. Lodraxhiun e kishim afër. Nji ditë e takova në udhë, nja nji orë para se t`i binte lodrës për iftar. Nuk m`u ndejt pa i thanë:

- Ore, bjeri asaj lodre nja pesë minuta ma para se nuk asht tue u ba kjameti.

- Unë i bije, por do thonë mileti na prishe ramazanin.

- Po ti bjeri veç për lagjen tonë, që na ke këtu afër.

- Po si t'i bije veç për ju?

- Për ne bjeri me karthi (thupër), se dëgjojmë; kur të shkojë sahati tamam, për të tjerët bjeri me topuz".

Unë isha i ri dhe, në biseda të kësaj natyre, ai duhej të përdorte **topuzin** që unë ta merrja vesh muhabetin që bënte **Sufa**, siç do ta thërrisnim shkurt atë.

Megjithkëto Isufi nuk na duhej për **"harta"** por, për të bërë transportin e materialeve që do na nevojiteshin gjatë punës në male, ndonëse edhe kjo punë nuk futej tek punët e rëndomta. Kishte dhe ajo të fshehtat e saj.

* * *

Në ndërmarrje më thonë se është caktuar për ju një zis me **shofer Bujar Lalën**. Me makinën e Bujarit mund të ngarkohen të gjitha materialet ndaj nuk do kemi nevoje për të dërguar dy makina në Radomirë. (Me këtë emër thirreshin pesë fshatrat e kësaj krahine në atë kohë, ndonëse sot me këtë emër thirren vetëm Stredoku dhe Radet). Kam porositur të bëjnë kujdes që materialet të vendosen me rregull dhe të sigurohen e lidhen nga sipër, pasi rruga është e gjatë dhe mund të lëvizin – përfundoi fjalën shefi i planit i ndërmarrjes, i **ndjeri Bajram Puca,** një njeri me zemër të madhe e të pastër. Me shef Bajramin, të cilin vite më vonë do ta kisha dhe drejtor, duhej të kishe kujdes. Shpejt nxehej dhe shpejt binte. Por, ajo që ishte e rëndësishme, ai nxehej vetëm për hallet e punës dhe nuk mbante inat. Pas gjithë atyre bubullimave, **që asnjëherë nuk binte shi,** të ftonte për kafe.

- Për çdo hall që të kesh më njofto. Do ju ndihmojmë me përparësi, pasi jeni ekip i largët e malor, dhe ik tani, puno mirë e na gjej mineral, jo në bulevardin e Peshkopisë, por maleve të Korabit – e përmbylli bisedën ai, pa harruar t'i japë dhe nuancat e humorit.

Ndonëse nuk kisha punuar me shoferin Bujar Lala, zërin ia kisha dëgjuar. Tani që kanë kaluar shumë vite dhe bora ka rënë mbi kokën time, po sistemoj shënimet që kam hedhur në çadër, pasditeve të vona nën dritën e qiriut, për punët dhe vështirësitë e punës së gjeologut, në këtë profesion fisnik, por, nuk gjeta veç fjalëve të mira për këtë njeri. Gjithkush e kërkonte Bujarin për të marre materiale pune, pasi ai ta hiqte mërzitjen dhe lodhjen kudo që të ishe me të, **në mes të rrugës** apo në majë të **malit**, në **çadër** apo në **hotelin** luksoz. Mbi të gjitha Bujari ishte një njeri shpirtmadh. Sikur t'ia bije dhe në majë të hundës - kur i thonë – ai kurrë nuk mërzitej. E ç'mund të thuash tjetër për këtë mik të gjeologëve që bëhej pjesë e halleve të tyre në çdo kohë e në çdo rrethanë. Ai që priste në ekip me orë të tëra inxhinierin apo punëtorin në ditët e shtuna për t'i ndihmuar që të ktheheshin në shtëpi, pasi me këmbë ishte pothuaj e pamundur. Ky ishte me pak fjalë **Bujar Lala.** Kanë kaluar shumë vite që nuk e kam parë, por për një gjë jam i sigurt, që ka mbetur po ai njeri që pata fatin të punoj dekada me radhë, me të gjitha ato tipare të mira njerëzore.

* * *

U nisëm për të vajtur në Radomirë, në fshatin Tejas, njërin prej pesë lagjeve apo fshatrave të kësaj krahine të njohur në të gjithë Shqipërinë. Ora kishte kaluar 11^{00} kur arritëm në Peshkopi. Përpara kishim shumë rrugë për të bërë. Ndaloj pak te zyra në Ekspeditën e Peshkopisë (i bënim qejfin vetes, se ato nuk ishin zyra por, në kuptimin e plotë të fjalës **ishin baraka**), për të marre disa materiale dhe një kasafortë llamarine, ku kisha vendosur disa dokumente gjeologjike për punimet fushore. Ndonëse ishim ekspeditë, nuk kishte akoma një kryetar dhe si i tillë thirrej me humor "**Drejtor Rremi",** tamam personi që ishte caktuar të punonte me mua si teknik gjeolog, por që, për arsye të ndryshme nuk do të punonte me mua në terren. Ky ishte **Muharrem Sturçe**, vëllai i këngëtarit të mirënjohur Abdyl Sturçe dhe shoferit të talentuar të autobusit të linjës Tiranë - Peshkopi të asaj kohe, Karafil Sturçe. Muharremi ishte i sëmurë, veç faktit tjetër që nuk mund të udhëtonte me makinë për disa arsye. Ai punoi gjithë jetën në Ekspeditën e Peshkopisë, derisa doli në pension të parakohshëm. Pas disa vitesh në pension ndërroi jetë. U bë për disa dekada simboli i ekspeditës gjeologjike të Peshkopisë, edhe pse nuk ishte **de jure kryetar i saj**. Shërbeu si normist dhe magazinier, njëkohësisht duke punuar me përkushtim e pa orar. Të mos harrojmë se në atë kohe ekspedita numëronte mbi 200 punëtorë dhe gjithçka kalonte nëpër duart e Muharremit. Nuk kishte as kompjutera dhe as makina llogaritëse elektronike. Shumë volume punimesh duheshin përllogaritur sipas normave duke përdorur një makinë mekanike, zhurmën e të cilës e kam akoma në vesh. Ai ishte personi më zyrtar që kam njohur deri më sot. Edhe pse fillimet e punës i ka pasur në punime fushore, në rilevime gjeologjike. Do ta gjej në zyrë për të mbaruar punë edhe në orët e vona të pasdites. Unë pata rastin që vite më vonë, në detyrën e kryetarit të kësaj ekspedite, të punoj me Muharremin, për të cilin do të ruaj kujtimet më të mira.

(Vijon numrin e ardhshëm)


**) Autori i këtij shkrimi ka gradën shkencore "Doktor", punonjës në Institutin e Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës.*

gjuha

Prof. Dr. Hajri Shehu sjell një studim praktik për mjetet e informimit të publikut, mbi standardet e gjuhës së shkruar dhe të folur shqipe. Të gjithë shembujt e dhënë në shkrimin e mëposhtëm janë marrë nga televizionet, radiot e gazetat e Tiranës.

Për **pastërtinë e gjuhës** së mjeteve të sotme të **informimit masiv**





Nga:
Prof. dr. Hajri SHEHU

(Vijon nga numri i kaluar)

Kur flitet për pastërtinë e gjuhës, çështja më e parë që mund të shqyrtohet është, siç u tha, ajo e fjalëve të huaja a me prejardhje të huaj. Dikush mund ta shohë hyrjen e fjalës së huaj në gjuhë si prajë, si infektim, si ndotje të gjuhës kombëtare. A e meriton fjala e huaj një qëndrim të tillë armiqësor? A janë të tilla të gjitha fjalët e huaja? Sigurisht, jo. Njihet teorikisht që sendi a dukuria (le të themi një shpikje teknike a teknologjike, një lojë etj.) hyn nga jashtë bashkë me fjalën, me të cilën shënohet. Në latinishte, p.sh., ka shumë huazime nga greqishtja. Por, po të ecim më tej në histori, do të shohim se shumë terma teknikë, shkencorë etj., që i quajmë grekë, kanë ardhur nga përtej tokës greke: *zenit, algjebër, gjeni, kalibër* etj. janë fjalë arabe. Edhe fjala *komb* është arabe. Kush mund ta pengonte që termat e muzikës të hynin në shumë gjuhë nga italishtja? Kush mund ta dinte, për shembull që fjala *satelit* e jo *sputnik* e rusishtes do të hynte në fjalorin (leksikun) e gjuhës shqipe? Kush mund t'i ndalte fjalën *pizhame* të urdishtes dhe *shampo* të indishtes të pushtonin shumë gjuhë të Europës? Pra, **gjuhët** nuk njohin kufij shtetërorë dhe as ligje bllokuese. Pra, më në fund, huazime ka në çdo kohë e nga shumë drejtime, madje, mund të thuhet se huazimi është po aq i vjetër sa edhe qytetërimi, sepse një send i dobishëm a një nocion abstrakt nuk mund të krijohet dy herë dhe prandaj mund të kalojë nga një popull te një tjetër. Fjala është dokument historik. Studiuesit shqiptarë, prof. Eqerem Çabej, prof. Idriz Ajeti, prof. Shaban Demiraj etj., kanë vërtetuar rolin dhënës edhe të shqipes. Pra, të nisesh nga një frymë paragjykuese e t'i shpallësh kryekëput të pavlefshme të gjitha fjalët e huaja është mbrojtja më e padobishme dhe zgjidhja më e padrejtë. Por, nga fjala e huaj *e panevojshme* ose nga formimi mbi bazën e fjalës së huaj *të panevojshme* duhet pasur njëfarë frike, sepse duke u përdorur shpesh, (kujto, p.sh. *implementim* e *implementoj*, *performancë* e *performoj* etj;) krijohet trualli për t'u futur në gjuhë, për t'u ngulur në trupin e shëndoshë të gjuhës shqipe standarde, e nuk do të jetë e lehtë të shkulet. Dhe, gjuhësisht njihen mekanizmat e mënyrat e hyrjes në gjuhë.

Është e vërtetë se gjuhët kanë bërë e bëjnë të vetën në të mirë të fjalës vendëse dhe kanë mjete e mekanizma për ta bërë këtë. Kështu, edhe shqipja. Ajo ka mjete e mekanizma në të mirë të vetvetes: natyra e saj, fjalori i saj (tërësia e fjalëve të saj), niveli i zhvillimit të stileve të saj, mjetet e mundësitë e saj fjalëformuese, mundësitë e saj sintaksore etj. e bëjnë atë të tillë. Megjithatë, gjuha e sidomos gjuha standarde nuk mund të mos varet nga kushtet e shoqërisë, nga njerëzit që e flasin atë, pra nga faktori subjektiv, veçanërisht, ai kulturor. Faktori subjektiv e sidomos, kulturor në zhvillimin e gjuhës standarde shfaqet përmes veprimtarisë njerëzore, e cila mund të jetë e formuluar edhe si program i politikës gjuhësore (p.sh., programi kulturor i Rilindjes Shqiptare), përmes qëndrimit estetik të shoqërisë ndaj gjuhës, përmes shijes gjuhësore kolektive (kujtojmë, p.sh., fjalën *bashki*: përdorej para Çlirimit, doli nga përdorimi, rihyri) etj. Atëherë, ne – gazetarët, shkrimtarët, gjuhëtarët etj. çfarë kemi në dorë? Ne kemi në dorë ligjërimin tonë, të folurin tonë, librat tanë, emisionet tona, tekstet ose kontekstet tona, kulturën tonë të ligjërimit, *zgjedhjen e fjalëve* e deri në njëfarë shkalle, edhe fjalorët tanë (qofshin ata gjuhësorë ose enciklopedikë). Në punë të zgjedhjes së fjalëve, shembull për t'u ndjekur janë njerëzit e futbollit e fjalori sportiv i futbollit. Tashmë, janë zhdukur nga fjalori i tyre e nga fjalori ynë fjalët e huaja *ence, gardalinë, aut, penallti, faull* etj. e në vend të tyre përdoren fjalë e formime shqipe.

Ku mund të gjendet fjala shqipe? Gazetarët, publicistët e politikanët e dinë fort mirë. Më së pari, te visari popullor, edhe për arsye historike që dihen. Pra, para se të huazojë nga anglishtja, italishtja etj., gjuha jonë e gazetës, e televizionit, e intervistës, e fjalimit etj. mund të huazojë nga gjuha e popullit. Pse, a nuk mundet, p.sh. që fjala *përfush* / vjen nga e folmja e Gurit të Bardhë, Mat, hetuar nga Rakib Lasku / ta zëvendësojë mirëfilli fjalën e huaj *ekspozoj* në kuptim të figurshëm? Po *ballinë* në vend të *fasadë* në kuptimin konkret, parësor e *tufë* në vend të *buqetë?* Dhëntë Zoti të mos e përdorim asnjëherë fjalën *snaiper,* por edhe për *snaiper* populli ka fjalën *shenjëtar.* Në fjalorët kombëtarë e krahinorë të shqipes ka shumë këshillime të tilla. Kemi fjalën shqipe; sa për shembull: *zbatoj* (a *përmbush)* për *implementoj; ngatërroj* (a *përziej)* për *implikoj; vëzhgoj* për *monitoroj; thelbësor* për *substancial; prirje* për *trend* etj. Një bazë tjetër e fuqishme janë formimet brenda shqipes, sipas gjedheve (modeleve) të saj fjalëformuese (p.sh., *përuroj* për *inaguroj, parashtrim* a *parashtresë* për *ekspozé, nismë* për *iniciativë, nismëtar* për *iniciator, përpunoj* për *elaboroj, ndërhyj* për *intervenoj, përligj* ose *shfajsoj* për *justifikoj, themelor, thelbësor, qendror* për *kardinal, mirëkuptim* ose *bashkëpëlqim* për *konsensus, bashkërendoj* për *koordinoj, besueshmëri* për *kredibilitet, vetëbesim* për *konfidencë, bashkëndihmesë* për *kontribut, më i shituri* për *bestseller, kujdestare fëmijësh* për *beibisiter, kryendeshje* a *kryegarë* për *derbi* (në parantezë: fjala është marrë siç shkruhet – *derby* / shqiptimi është *dabi;* në zanafillë është emër i përveçëm vendi, ku ka nisur gara me kuaj, themeluar nga Duka XII i atij vendi, në shekullin XIX), *ndjeshmëroj* për *sensibilizoj* etj.). Kur s'ke pulën, hahet edhe sorra. Atëherë, bëjnë punë edhe shqipërimet e pjesshme (parashtesa, prapashtesa etj. shqipe; p.sh., s'kemi pse themi **pan***afrikan* e **inter**kontinental, themi **gjith***afrikan* e **ndër**kontinental; në vend të *park***ing** themi *park***im;** në vend të **de***montim (demontimi i predhave)* themi **ç***montim* / *çmontimi* ...; në vend të **bi***partizan* themi **dy***parti***ak** etj.) a huazimet e përkthyera nga gjuhë të huaja (gjuhësisht: kalket), mundësisht, sipas gjedhes e natyrës së gjuhës shqipe (le të themi, **auto***sugjestion* ® **vetë***ndikim).* Dhe, në parantezë: parapëlqejmë edhe fjalë të huaja a terma të huaj, a formime mbi bazën e fjalës së huaj, por *me shtrirje e me traditë të gjerë përdorimi* sepse vetë gjuha parapëlqen dysorin më të vjetër ngaqë e ka përvetësuar atë; atëherë, më mirë *paraprojekt* se *draft,* më mirë *këshill* ose *komision* se *bord,* më mirë *personel* se *staf,* më mirë *dosje* se *fail,* më mirë *redaksional* se *editorial,* më mirë *Bajrami i Ramazanit* se *Fitër Bajrami,* (sikur të mos kishim *ndikim*) më mirë *influencë* se *impakt,* më mirë *interpretoj* se *performoj* (është fjala për shfaqje në skenë) etj.

Besojmë se ka libra të mjaftueshëm për t'u këshilluar për fjalën shqipe. Janë Fjalorët e gjuhës së sotme shqipe (1980, 1984, 2002, 2004, 2006), fjalori "Për pastërtinë e gjuhës shqipe", "Fjalor i fjalëve të huaja" (Prishtinë) e shumë fjalorë krahinorë të shqipes, "Gjuha letrare shqipe për të gjithë", A. Xhuvani, vepra I, dy revistat "Gjuha jonë" (Tiranë), "Gjuha shqipe" (Prishtinë), "Kultura e gjuhës" (Prishtinë), "Gramatika e gabimeve" (Shkup) etj. Mund të kishte edhe një "Fjalor i shtypit". Më mirë se gazetarët nuk mund ta bëjë kush këtë fjalor. Por, sigurisht, për fjalë të tilla, si, *akseptoj, alinjohem* (nuk pranon të *alinjohet* me ...), *alokoj* (*alokoj* fonde), *anunçoj, benefit, bestseller, crucial, çekoj (çekojnë* cilësimet), *dekonfliktoj, disponsibël, disraport, distributor, dominancë, efiçensë, elaboroj, embarkoj, feirplei, fragile / fraxhile, fulltaim, imperativ (*është *imperativ) i induktuar, impostoj, inefikas, inovativ, intension* (do të njoftoj për *intensionet* e qeverisë), *interkoneksion, inventoj, involvohem, irracionalitet, kast* (pjesë e *kastit* realizues), *kauntdaun, kompatabilitet, kompetitiv* (avantazh *kompetitiv), komportohet, konsistent, konstituohet, kontagioz (*sëmundje *kontagioze*), *kooperacion (kooperacioni* italian), *korent* (borxh *korent), lendfill, menaxherial* (gjendja *menaxheriale), ministerial* (në *ministerialin* e mbrojtjes), *moderacion, multiplikatoj, naval, nominoj (*nuk *nominohet* kandidat*), obligativ, obstruktiv, onturazh (onturazhi* i politikanëve), *oshilacion, overdozë, parttaim, pircing* (ardhur nga një *pircing* banal), *presing, previzion, prezumohem, probabilisht, promocion, promocional, prevalencë, prevenoj, relaks, rest (*Perëndimi është kundër *restit* të botës), *restriksion, retension, star* (botoi *starin* e filmit), *substancial, superficialitet* (tregues i *superficialitetit* të vizioneve të tij), *supervizoj, toplist, trend* (ka një *trend* pozitiv), *vokabular, workshop* (ndiqni një speciale rreth një *workshopi* për vlerat e ...) etj. librat e mësipërm nuk mund të vlejnë. Për to duhen fjalorë dygjuhësh, sidomos, anglisht-shqip.

Ka botime të huaja që tregojnë si ta mbajë dorën një fjalimmbajtës kur përshëndet në një takim popullor. Mirë. Por, më shumë se kaq, fjalimmbajtësit a të intervistuarit tonë i duhet të përzgjedhë e të zgjedhë fjalën se e ka për të tjerët e jo për vete. Gjuha është e të gjithëve dhe ruhet e zhvillohet nga të gjithë; por shtypi e gazetaria televizive e radiofonike kanë një rol të veçantë sepse kanë shumë lexues, shikues e dëgjues. Ka një lexues, shikues a dëgjues kritik, që e dallon ç'është e drejtë dhe ç'është e gabuar; por ka edhe një tjetër, që në mënyrë të pavullnetshme mund të përvetësojë edhe atë që është e gabuar, në rastin tonë, fjalën e huaj të pavend. Prandaj mjetet e informimit masiv mund të ruajnë veten, por mund të ruajnë edhe të tjerët. Gjuha është kulturë që mësohet e edukohet. E, mjetet e informimit masiv kanë ndikim të fuqishëm në mësimin e në edukimin e të tjerëve me kulturën e gjuhës, sepse kanë në dorë fjalën, sepse janë propagandues e organizatorë masivë, sepse rrokin të gjitha anët e jetës shoqërore, prodhuese e kulturore, sepse i njohin në mënyrë të drejtpërdrejtë rrethet më të gjera të lexuesve, të shikuesve e të dëgjuesve me dukuritë e reja etj. Nuk mund të harrohet, gjithashtu, se u japim fëmijëve tanë fjalorin e së ardhmes: fëmijët e marrin këtë fjalor e këtë gjuhë aty ku e solli brezi i mëparshëm. E, brezi i mëparshëm jemi ne. Atëherë, le t'u mësojmë fëmijëve **fundjavë** në vend të *uikend,* **kam** a **zotëroj** në vend të *posedoj,* **letërnjoftim** në vend të *kartë identiteti,* **frymëzoj** në vend të *inspiroj,* **ndikim** në vend të *impakt,* **i drejtpërdrejtë** *(transmetim i drejtpërdrejtë)* në vend të *llaiv,* **nis** në vend të *startoj,* **gaztor** në vend të *kloun,* **rënie** në vend të *depresion (depresion i madh ekonomik),* **ndërhyj** në vend të *interferoj (të mos lëmë të interferojë politika),* **hetoj** në vend të *investigoj,* **trondit** a **trand** në vend të *shokoj,* **pranoj** a **miratoj** në vend të *akseptoj,* **ngutësi** në vend të *emergjencë,* **ngulmoj** a **këmbëngul** në vend të *insistoj* etj. Le t'i mësojmë ata të zgjedhin më të mirën.

Shenim: Këtu është fundi i studimit të prof. Dr. Hajri Shehu. Dy pjesët e para mund ti gjeni në arkivin e gazetes "Rruga e Arbëri" ne internet në adresën "www.dibra.org"

Kronikë e një historie terrorizmi: A janë tre dibranët të përsfhirë në akte terrorizmit kundër SHBA. Juria i shpall fajtorë por vendimin gjykata do ta japë në prill të vitit 2009

Tre dibranët e Fort Dix-it

Gjyqi i shpall me faj. Vendimin do të merret në prill 2009. Avokatët mbrojtës: "Klientët tanë janë të pafajshëm, i kanë dhënë shumë gojës "



Nga **BEQIR SINA, New York**

CHERRY HILL, NEW JERSEY: Juria fedrale ka shpalluar pas gjashtë ditë dëgjimesh pesë të rinjët që akuzoheshin se kishin komlpotuar për të vrarë ushtarët e Fort Dix-it. Mes të akuzuarve ishin edhe tre vëllezër shqiptaro - amerikanë, me origjinë nga Dibra e Madhe. Përndryshe, vëllezërit Duka janë shqiptarë që kanë punuar në një biznes familjar, amerikani me prejardhje turke është imigrant i ligjshëm që ka punuar si asistent menaxher për 7-Eleven në Filadelfi, përderisa shtetasi amerikan, i cili është i lindur në Jordani, ka punuar si taksi-vozitës dhe në një shitore që është pjesë e biznesit të tyre familjar.

Akuza për vrasje me paramendim e mbetur në tentativë u rrëzua - por akuza e parë mjafton për të marrë një dënim me burgim të përjetëshëm. Masën e vendimit do të caktojë gjykatësi i çështjes në një seancë speciale që pitet të mbahet në muajin prill të vitit të ardhëshëm. Shpallja e dënimit për të dënuarit është caktuar për 22 prill për tre vëllezërit, ndërsa për dy të tjerët për 23 dhe 25 prill, të vitit të ardhshëm. Të akuzuarit.... pesë personat, tre prej të cilëve shqiptarë emigrantë nga Dibra e Madhe, të cilët akuzoheshin për komplot në bazën ushtarake në Fort Dix, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në përfundim të gjyqit të ngritur kundra tyre, janë shpallur fajtorë nga një juri e posaçme e përbërë nga 11 veta, 8 gra dhe 3 burra. Gjyqi ndaj tyre u zhvillua në gjykatën federale distrikti i Camden në Nju Xhersi.

Të akuzuarit Dritan Duka 28 vjeç, Shain Duka 26 vjeç, Elvir Duka 23 vjeç, që të tre shqiptarë nga Dibra e Madhe (fshati Spase), dhe i akuzuari me origjinë turke Serdar Tatar 23 vjeç, dhe një jordanez Mohamad Ibrahim Shnewer, 22 vjeç, akuzoheshin se kishin pasur si qëllim të kryenin sulm në bazën ushtarake Fort Dix. Me këtë vendim të pesë personat në se mbetet deri në prill 2009, në fuqi kjo akuzë, ata mund të përballen me një dënim deri në burgim të përjetshëm.

Sipas prokuroreve, te peste kerkonin te nisnin nje sulm ndaj bazës ushtarake por mbrojtja e te akuzuarve i hodhi poshte deklaratat. Ndonese nuk ishin akuzuar se kishin lidhje me ndonje grup terrorist nderkombetar, hetuesit dolen ne perfundimin se te peste ishin frymezuar. I arrestuar ka qenë dhe shqiptari tjetër, Agron Abdullahu, i cili është liruar duke ju dhënë një dënim i cili ishte i barabartë me kohën sa ai kishte qëndruar në burg.

AKUZAT

Tre nga të dyshuarit, vëllezërit Shain, Dritan dhe Elvir Duka, janë emigrantë nga Maqedonia - Dibra e Madhe, fshati Spase, ndërsa Muhamar Shnefer është nga Jordania dhe Serdar Tartar me origjinë nga Turqia. Ata akuzohen nga FBI-ja për komplot ndaj bazës amerikane, dhe për përgatitje të veprimeve të armatosura për të vrarë ushtarët amerikanë. Të pestë të akuzuarit, përfshi tre shqiptarët, të përfaqësuar gjatë gjykimit nga dy avokatë amerikanë, kanë provuar pafajshëmërinë e kilenteve të tyre. Ata bënë para pak kohësh një kërkesë për shtyrjen e gjyqit. Sipas akuzave që janë ngritur të gjashtë, u arrestuan në muajin maj të vitit 2007, pas një operacioni 15-mujor investigimi nga ana e FBI-së, që sekuestroi edhe një sërë materialesh që hetuesit i cilësojnë si të dyshimta.

ZBULIMI

FBI-ja, tha se i ka nisur hetimet në fillim të vitit 2006, pasi dikush kishte çuar në një dyqan videosh disa filmime për t'i hedhur në format DVD. Në video dukeshin 10 burra, përfshirë këtu edhe gjashtë të arrestuarit, të cilët stërviteshin me rroba kamuflazhi në një terren malor në mes një pylli, në malet e Nju Jorkut - Poconoas. Ajo që ishte shqetësuese për hetuesit amerikanë lidhej me faktin se me fillimin e përgjimit gjatë stërvitjes së tyre me armë nëpër pyll, ata duken se stërviten e bëjnë edhe qitje me armë zjarri.

Një nga deshimtarët, i cili tashmë nuk është më sekret, pasi njihet si informatori i FBI-t, njeri me prombleme në Shqipëri, pas ka tentuar të bëjë një vrasje, tregoi për prokurorin e shtetit se njëri prej të dyshuarve punonte si shpërndarës picash në bazën ushtarake të Fort Diksit. "Ai shpërndante pica për ushtarët në bazë dhe kjo i kishte dhënë atij mundësinë të njihte terrenin, hyrje-daljet dhe cilat ishin aktivitetet që kryheshin aty." Gjyqi tregojë se ndaj të akuzuarave që në fillim të vitit 2006 filloi vëzhgimi i tyre. Ky grup ishte në vëzhgim prej 16 muajsh dhe janë dokumentuar kur ata praktikonin goditjen në malet Pokono, në verilindje të Nju Jorkut dhe Pensilvanisë.

AVOKATËT

Avokatët e mbrojtjes pohonin se personat asnjëherë nuk kanë qenë seriozë lidhur me sulmin mbi Fort Diksin, dhe se informatorët qeveritarë vazhdimisht "i kanë shtyrë në inskenimin e komenteve të xhiruara në videoshiritet".

Mbrojtja e sulmoi edhe kredibilitetin e informatorëve. Njëri është egjiptian, imigrant i paligjshëm, i cili ka qenë i dënuar me kusht për shkak të mashtrimit bankar dhe i paguar nga FBI me 230 mijë dollarë, ndërsa tjetri ka marrë rreth 150 mijë dollarë.

Avokatët mbrojtës u përpoqën të tregonin dje edhe një herë para se prokurori Mur të jepte vendimin, e trupit gjykues, ku të arrestuarit u akuzuan se kan pasë qëllim të kryejn komplot ndaj bazës ushtarake në For Dix, se të pestë të akuzuarit, "Ishin llafazanë, mburravec, të pa shkollë dhe budallenjë e jo terrorista" .

Avokatët madje direkt në gjyq akuzuan edhe FBI-n, se kishte ngjitur, copa informacionesh që nuk formonin një figurë të plotë dhe se njerëzit e futur për t'i përgjuar ishin keqbërës që ishin kapur në flagrancë e që kishin kompromentuar me qëllim hetimin.

Në një dekleratë të jurisë, e cila përbëhej nga 8 gra dhe tre burra, ermat e të cilëve janë sekret, thuhej se vendimi kishte qënë shumë i vështirë për t'u marrë dhe se ata ishin menduar mirë përpara se të vendosnin. Jurisë i u deshën 6 ditë dhe 38 orë dëgjime për të arritur në vendimin e dhënë.

REAGIMI I KOMUNITETIT MUSLIMAN NË SHBA

Shpallja e vendimit ka sjellë reagimi negative nga komuniteti musliman i Philadelphias dhe New Jersey-t, James Yee, ka shërbyer si hoxhë në burgun ushtarak të Gjirit Guantanamo dhe në vitin 2003 u akuzua se kishte shpërdoruar materiale sekrete duke i a përcjellë një spiunazhi të huaj. Ai u arrestua por gjyqi se shpalli fajtor.

I pyetur nga gazetarët , ai tha se gjyqi për Fort Dix-in, u bazua mbi një akuzë të dobët pa fakte të mjaftueshme.

"Duket sikur në kushte normale, nëse nuk do të nxiteshin nga zgjentët e FBI-t, ata nuk do të kishin ndërrmarë kurrë sulm të dhunëshëm", tha ai. "Kjo nuk do të ndihmojë për të fituar besimin e komunitetit musliman amerikan. Është komuniteti ynë ai që mund të përmirësojë sigurinë e këtij vendi, por për këtë duhet të trajtohemi si partnerë e jo si të dyshuar".

Mohamed Younes, presidenti i Unionit Musliman Amerikan në Paterson, të New Jersey,t, tha se nuk mendonte se akuzuarit kishin vërtet ndërmend të kryenin sulmin. " Ata e shihnin të gjithë këtë si shaka. Nuk duken si njerëz që do t'a bënin një gjë të tillë."

"Për muslimanët ky është një kurth", tha Jim Sues, drejtor ekzektutiv të degës së New Jersey-t, të këshillit për Marrëdhënie Amerikano Islamike(CAIR) i cili ndoqi gjyqin në sallë çdo ditë.

ARRESTIMI TYRE, "ZGJOI" LOBIN SERB T'I AKUZOI SHQIPTARËT PËR TERRORIZËM

Një jehonë e paparë i është bërë arrestimit të katër shqiptarëve nga mediat serbe në Sërbi dhe në SHBA-së. Kjo vlen, pa përmendur artikujt dhe komentet në gazetat e tyre, ku sidomos personalitete, por dhe njerëz të thjeshtë serbë dhe serbo-amerikanë i akuzuan shqiptarët, se kanë janë "terrorista islamik".

Kaq të forta kanë qenë këto komente, sa u desh që një zyrtar i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit t'a konsideronte si një "grup të izoluar" dhe që vepronte në mënyrë autonome grupin e gjashtë të arrestuarve. Por as kjo deklaratë nuk e "zbuti" qëndrimin e këtyre komentuesve.

Mjafton një kërkim i thjeshtë për atentatin e planifikuar në "Fort Diks" dhe vërehet lehtësisht se pjesa dërrmuese e artikujve, por dhe e komenteve për këtë çështje, i takon kësaj kategorie, që përpiqet të përshtatë në një mënyrë a në një tjetër këtë ngjarje në kontekstin e "terrorizmit islamik", që sipas tyre gëlon në mesin e shqiptarëve.

Gjithsesi, përtej këtyre komenteve, është fakt se ende shqiptarët nuk janë gjykuar, nga autoritetet amerikane se janë terroristë ose kanë lidhje me ndonjë grupë terroristë. Gjykimi i tyre dhe autoritetet amerikane e kanë mohuar në mënyrë të prerë ekzistencën e ndonjë mbështetjeje për të arrestiuarit shqiptarë, nga ndonjë shtet ballkanik apo nga ndonjë organizatë terroriste.

KUSH JANË TË AKUZUARIT?

Katër prej të arrestuarve ishin shqiptar, njëri nga Jordania dhe njëri nga Turqia. Të gjithë jetonin prej vitesh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si emigrantë të ligjeshëm dhe të pa -ligjëshëm. Tre prej tyre jetonin ilegalisht në Shtetet e Bashkuara, dy kishin leje pune, kurse vetëm njëri prej tyre ishte qytetar amerikan. Të arrestuarit, të identifikuar nga letrat e gjyqit me emrat Muhamar Ibrahim Shnewer, Dritan Duka, Elvir Duka, Shain Duka, Serdar Tatar dhe Agron Abdullahu, pasi janë arrestuar një vit më parë, janë "filtruar" me të dhënat që zyra e emigracionit kishte për ta.

Duke u ballafaquar me dokumentet e zyrës së emigracionit dhe natyralizimit del se Dritan Duka, Elvir Duka dhe Shain Duka jetonin ilegalisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pesë prej të arrestuarve jetonin në Cherry Hills të Philadelphias, rreth 20 milje (30 km) larg nga baza "Fort Diks". Sipas autoriteteve amerikane, ata kishin pasur si qëllim ta sulmonin në këtë bazë . "Fort Diks" është një bazë që përdoret për trajnimin e rekruteve të rinjë, sidmos për ata që përgatiten për në Irak e Afganistan. Kjo bazë gjithashtu është përdorur për të strehuar refugjatët nga Kosova në vitin 1999. Baza gjithmon ndodhet në gjendje gatishmërie të lartë dhe ka një siguri ekstremisht të lartë në të gjithë zonën, pas i përket një zone ushtarake.



Naze Duka, gjyshja e tre vellezërve të arrestuar dhe Elez Duka, kusheriri i tyre në Dibër të Madhe. Foto e AP, nga Visar Kryeziu

Të gjithë ata që ndoqën zhvillimim e mbledhjes në OKB, e rëndësishme për sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, pane dhe u binden për nivelin e mangësisë së Republikës së Kosovës në rafshin diplomatik.

ME SHKAS PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

Sfidat e pavarësisë dhe mangësia e diplomacisë



Nga
REXHEP TORTE

Ne shqiptarët nuk mund të kërkonim rast më të mirë se mbledhja ditë më parë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së lidhur me Gjashtë pikat e Ban Ki Moonit për konfigurimin e UNMIK-ut dhe shtrirjen e EULEX-it.Ishte mundësi e mirë për të shprehur para botës të vërtetën dhe për ta diskreditуar politikën serbo-ruse ndaj Republikës së Kosovës.

Të gjithë ata që nëpërmjet ekraneve televizive ndoqën zhvillimim e kësaj mbledhje të rëndësishme për sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, pane dhe u binden për nivelin e mangësisë së Republikës së Kosovës në rafshin diplomatik.


DIPLOMACIA LYP MJESHTËR TË POLITIKËS

Skender Hyseni, ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, në këtë mbledhje nuk la përshtypjen e një diplomati të duhur. Ishte përparësi e madhe që para ministrit tonë të jashtëm folën L'alberto Zanieri, i dërguari i OKB-së Kosovë dhe Vuk Jeremiq, ministër i jashtëm i Serbisë. Ministri ynë pas paraqitjes së këtyre dy parafolësve, duhej që ad hok të paktën t'i përgjigjej zotit Zanieri, se acarrimet ndërtenike në Republikën e Kosovës nuk i krijojnë shqiptarët, por pakica serbe e instrumentalizuar dhe e udhëzuar nga Beogradi. Ministri Hyseni ishte e udhës t'i përgjigjej edhe homologut Jeremiq, qoftë edhe në disa pika, se dokrat serbe nuk qëndrojnë, se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte legjitime dhe domosdoshmëri për të shpëtuar njëherë e përgjithmonë nga çizma shekullore serbe, nga dhuna, vrasjet dhe gjenocidi i përsëritur serb ndaj shqiptarëve të Kosovës,sidomos në luftën e fundit, duke ia numëruar vrasjet, djegiet e dhunimet.

Ministri ynë edhe kur e mori fjalën për herë të dytë,duhej të paktën me disa fjali të qartësojë katër pikat e Republikës së Kosovës, kundrejt propozimit të Ban Ki Moonit dhe tu përgjigjej gënjeshtrave të Jeremiqit. Asnjëherë nuk mjafton të flitet për viktimat dhe masakrat e tiranisë serbe, e as të presim që popujt e tjerë apo përfaqësuesit e tyre diplomatikë t'i kenë të qarta dhe t'i ndjejnë siç duhet të gjitha të zezat që pësuan shqiptarët në Kosovë.

UKSHIN HOTI PREFERONTE KUADRO PROFESIONISTE

Mr Ukshin Hoti politollog i dëshmuar,



Faksimile e hartës së Enciklopedisë Ruse që tregon kufijtë realë të Serbisë në vitin 1817

përveç detyrës që kryente, pjesën tjetër të ditës e kalonte duke lexuar e studjuar në vazhdimësi. Ai i preferonte dhe respektonte njerëzit e profesionit dhe të dijes.

Më kujtohet një rast kur një shoku im me të cilin punoja që kishte mbaruar albanologjinë dhe kishte regjistruar studimet pasuniversitare të diplomacisë në Zagreb, kishte dëgjuar se unë e kam shok të ngushtë Mr. Ukshin Hotin, e mu lut t'i mundësoj të takohet me të për ta udhëzuar lidhur me studimet pasuniversitare.

Kur i tregova Mr. Ukshin Hotit se një albanolog kishte vendosur të bëhet diplomat, ai kategorikisht refuzoi të takohet me të, me arsyetimin , se çfarë diplomati mund të bëhet ai pa asfarë baze të shkencave politike,që me siguri nuk i ka lexuar as tre vëllimet voluminoze të Historisë së diplomacisë.Koha tregoi se qëndrimi i Mr. Ukshin Hotit ishte me vend.Ky albanolog sot e kësaj dite mban titullin Dr.i diplomacisë, por në të vërtetë në këtë profesion zëri i tij si diplomat nuk po ndihet askund.

PËR TË ZEZAT SERBE DUHET FOLUR PARRESHTUR

Kjo mbledhje e KS e OKB-së, dëshmoi edhe njëherë se udhëheqësia e Republikës së Kosovës dhe sidomos diplomacia e saj, nuk duhet të ngurojë që në të gjitha takimet me të huajt të flet parreshtur për dhunën e vrasjet serbe ndaj shqiptarëve.

Kur jemi këtu nuk mund të lë pa përmendur edhe njëherë se, Ban Ki Moonit, diplomatëve në OKB dhe tërë burështetasve botërorë , duke mos përjashtuar as shtetarët serbë e rusë, duhet tu dërgohet libri i përkthyer anglisht, frengjisht apo gjermanisht "Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë" i autores kosovare Luljeta Selimi.

Secili diplomat, burrështetas apo familjarë të tyre që do ta lexonin këtë libër, do të rrënqetheshin kur do të kuptonin e mësonin se çfarë krimesh kanë bërë ushtarët e policët serbë edhe ndaj femrave shqiptare në Kosovë, dhe se me siguri më në fund do të bindeshin që pa mëdyshje të jenë në anën e të vërtetës dhe të shtetit të ri të Kosovës.

LIBRI I NDJENJAVE SHTAZARAKE SERBE

Ja disa grimca nga ky libër që shpreh sjelljet shtazarake të ushtrisë e policisë serbe në Kosovë. " Ma pushkatuan nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin tim e masakruan për së gjalli me cigare". Një nga mjeket deklaron se,"Vajzës së dhunuar i ishte shqyer mitra dhe se në organet gjenitale i kishn futur rërë, këmbët i kishte të gërvishtura dhe mes dy gjinjëve me majën e thikës kishte të vizatuar kryqin serb". Ose rrëfimet e tjera," Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vrarë, e mua më çnderonin vetëm disa metra larg tij"," Pasi ma vranë djalin, mua më çnderuan disa ditë me radhë", "Djalit dy vjeçar ia prenë veshin dhe tre gishtërinj, e pastaj më dhunuan", "Më dhunuan para syve të nënës", "Më dunuan e ma prenë gjirin", "Cigaren e ndezur e fiki në gjinjtë e mi", "Me thikë shkruan fjalë mbi trupin tim, "Më detyronin t'i shiqoja femrat që po i dhunonin me radhë", "Pasi më dhunuan, m'i hoqën thonjtë me dana", "Motrën e mbytën me kundak të pushkës", "14- vjeçarja u dhunua në borë", "Pasi e dhunuan 13-vjeçaren e hudhën në pus", "Më çnderuan para syve të babait dhe nënës", "Në muajin e tetë të shtatzanisë më përdhunoi para vjehrës dhe burrit, e pastaj më goditi në gjoks e në bark dhe linda fëminë e vdekur", " Më dhunuan dhe në krah ma vizatuan kryqin serb", "Pasi i çnderuan tri vajza, ua prenë organet gjenitale". Ky libër duhet përkthyer dhe shpërndarë sa më parë në se duam t'I demaskojmë serbët gjakpirës dhe t'I ndihmojmë Republiës së Kosovës.

MASAKRAT NUK DUHET FSHEHUR

Ka me mija fakte të zeza për ta dëshmuar egërsinë e gjenit serb ndaj shqiptarëve në përgjithësi dhe të Kosovës në veçanti. Këto fakte në vazhdimësi duhet duhet përsëritur e nxjerrë në sipërfaqe dhe nuk duhet lejuar t'i mbulojë pluhuri i kohës.Sa më shumë që i sheshojmë të zezat serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, aqë më shumë dhe aqë më shpejt do t'i ndalim dhe gjunjëzojmë përpjekjet serbe për t'I fshehur këto të zeza.Aqë më tepër kur këtyre ditëve serbët marrin guximin për të kërkuar nga faktori ndërkombëtar tani edhe revidimin e Marrëveshjes së Kumanovës të vitit 1999, me synim që ta sjellin sërish ushtrinë e policinë serbe dhe të shtrijnë dorën grabitqare tashmë edhe në Shtetin e ri të Kosovës.

Pajtohuni në gazetën "Rruga e Arbërit"

www.dibra.org

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

Pajtimi në gazetë kushton 600 lekë në vit dhe gazeta ju vjen me postë në shtëpinë tuaj...

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Refleksione mbi esete e dy studentëve shqiptarë në Itali.
Një temë e mundshme debati e studimi për psikologët, mësuesit, profesorët, gjenetikanët, sociologët, etj.

Dy përralla dhe dy histori

Shpjegim historik apo gjenetik?

Nga: Dr. Selman Mëziu

Janë dy fëmijë, të qetë në karakter, të bukur e simpatik si të një peizazhi bjeshke në pranverë. Të lindur muajt e fundit të shekulli të njëzetë. Njëri me emrin Nezir Halilaj nga Llapçeva e Kosovës, tjetri Mikele nga Firencia, prindërit Dibran, buzë drinas. Mësojnë, në klasë të tretë disiplina të ndryshme, kuptohet në gjuhën italiane. Ndihmojnë njëri-tjetrin, në mësime, në kohën e lirë bisedojnë, luajnë futboll së bashku. E kështu ato zbaviten me fëmijërinë e tyre plot andralla, të qetë e me dëshira të mirë plotësuara. Në përfundim të vitit shkollor 2007-2008, në librin e hartimeve më të mira janë radhitur edhe të tyreve. Deri këtu asgjë për të zgjuar kureshtjen. Po përshtatim në shqip rrëfimet e tyre.

I - NJË HERO GUXIMTAR

Ishte një herë një mbret me emrin Nezir, i cili banonte në një KËSHTJELLË, larg, shumë larg. Në të vërtet Neziri ishte një lloji heroi që mund të quhet Teksas Rengjers Korder. Ky ishte një burrë nga qyteti Amerikan i Teksasit më i miri nga të gjithë banorët e tij.

Një ditë prej ditësh, një vrasës i tmerrshëm i vendos një gjarpër në makinë, ky e kafshon në njërën dorë. Rengjers bie në tokë, mbylli sytë, e dukesh se po vdiste nga helmi që lëshoi gjarpëri.

Por fatbardhit i erdhi një ambulancë fare rastësisht, e menjëherë i bëjnë një gjilpërë kundër helmimit. E, për mrekulli ai shpëtoi.

Ç'far mund të mendojmë për këto pak rreshta? Po për moshën fëminore me këtë fantazi heronjsh? A mos është vallë një shpërthim gjenetik? A po ligjësi trashëgimie gjenesh nga brezi në brez?

A mund të na vijë në ndihmë ngjarjet e mëdha historike? A nuk ishte pesëmbëdhjetë qershori i vitit 1389 beteja më e përgjakshme e kohërave. Ku vihen përball njëqind mijë luftëtarë shqiptarë, serbë, bullgarë, hungarez, çekë e Polakë me treqind mijë ushtarë Turq.

Morën pjesë Sulltan Murati I, mbreti Boshnjak Tverko, shqipëtarët të kryesuar nga Gjergji II Balsha dhe Teodori II Muzaka, ndërsa Rumunët kryesoheshin nga Vojvod Mirçea. Luftimet u zhvilluan në Fushë-Kosovë. Pikërisht midis Prishtinës e lumit *Llap*.

Gjaku arriti në gju të kalit. Trupa njerëzish pa koka, krahë ose këmbë, kuaj të shtrirë për dhe që nga goja nxirrnin shtëllunga gjaku. E në këtë zallahi makabre gjeti vdekjen nga prijësi i shqiptarëve të Kosovës *Millosh Kopliç*. Sulltan Murati I, udhëheqësi i legjioneve osmane, ndërsa tehu i mprehtë e i pamëshirshëm i shpatës së ushtrisë kundërshtare la të prehet në këtë mizëri kufomash edhe princin Serb Llazar Hrebljanoviç.

A nuk u quajt udhëheqësi popullor Isa Boletini, Garibaldi shqiptarëve nga gazetat perëndimore në Luftën Ballkanike? Dy fundvitet e shekullit të njëzetë ishin për popullin e Kosovës një terrorizëm i papërshkrueshëm, varrosje të gjallësh, fëmijë, pleq e plaka të gjymtuar. Ë mijëra e mijëra të tjerë që largoheshin nga vendi i tyre drejt Shqipërisë, Maqedonisë, etj. Terrorizmi i policisë e ushtrisë së Millosheviçit për pastrim etnik, shkatërroi gjithçka shtëpi, shkolla, blegtori, si një sunam i përbindshëm.

Në janar të dymijë e tetës, Kosova shpallet shtet i pavarur, me ndihmën e pakursyer të presidentit Amerikan, *Xhorxh W. Bush*. Heroi kryesor i krijimit të Nezirit, Kështjella, figurat letrare, *gjarpëri, helmi, ambulanca e Teksas Rengjers Korder*, janë figura që gjejnë shtratin e vetë në historinë shumë planshe të mëmëdheut të tij, KOSOVES.

II - MBRETI FILIP

Ishte njëherë një qytet që quhesh Iamala. Banorët e qytetit ishin shumë të hidhëruar në shpirt, sepse nuk kishin një mbret që të qeveriste qytetin. Ndodhnin këtu gjithfarë lloje ngjarjesh.

Një ditë prej ditësh, banorët vendosën se cili njeri do të gjente përkrenaren e artë do të bëhesh mbret. Banorët e qytetit e dinin se kjo ndodhesh në një tub të gjelbërt, diku nën dhè. Në kërkim të saj, morën pjesë njëqind e dhjetë persona. Një ndër të cilët ishte një djalosh i ri, që quhesh Filip.

Ai gërmoi në një vend derisa gjeti një valigje, brenda së cilës gjeti një tub të gjelbërt, ku brenda së cilës ishte përkrenaria prej ari. Ai e vuri atë në kokë dhe u bë mbret. Kështu Filipi, bëhet udhëheqës i Iamalës. Ai martohet e jeton i lumtur me gruan e tij. E kështu qyteti nuk pati më kurrë probleme të çfarëdo lloji natyre qofshin.

Ku të jetë vallë fillesa e frymëzimit? Apo ndonjë shpërthim i pakontrolluar gjenesh?

Sikur ti drejtoheshim historisë, se mos ndoshta diçka do të rizgjonim për të gjetur përgjigje. Dhe ja ta shfletojmë.

Ishte viti 360, kur forca të shumta Ilire u zmbrapsen nga Mbreti Maqedonas, Filipi. Nuk kaluan veçse katër vjet dhe Mbreti Ilir, Bardhyli, ndërmerr një sulm tjetër kundër Mbretërisë Maqedonas. Ushtria e Mbretit Filip nuk ndalet në mësymjen e saj deri në brigjet e Adriatikut, duke krijuar kështu një shtet shumë më të madh nën sundimin e tij.

Dhe më tej, pema e jetës vazhdon, Olimbia nëna a Aleksandrit të Madh, ishte motra e Mbretit të Epirit (*I Epërm*, pra Shqipëria verore, apo "*Barbaret*" e Herodotit) Aleksander Mollosit. Dhe pas vdekjes së parakohshme të të birit ajo grua fisnike, me karakter burrëror bëhet Mbretëreshë e Shqipërisë Verore (*Epirit*).

Ndërsa në një studim të vitit 1920, Mid'hat Frashëri shkruan: "Aleksandri, djali i Olimbisë, me Shqiptarët nga e Emadhia (*Dibra*) themeluan Alaeksandrine (Skënderien)

Historiani Hysen Lala, shkon më tej, ku shkruan: "Sipas gojëdhënave mund të thoshim nga ana jonë se edhe Filipi, i ati i Alaksandrit të Madh, e kish kryeqytetin në Fushë *Pela* të Lurës (*Lyre-Ilyri-Iliri*) dhe për kujtim të vendlindjes së tij, e quajti kryeqytetin e ri të Maqedonise së vjetër *Pelagia*. Madje, patrioti i pavarësisë Murat Toptani e formulon kështu mendimin e tij poetike për të: "Dimnit në Selanik zbriste, /

Ë verën në Mat - Qidhën qiste, / Mbi një at vend që i thonë *Qytet*, / Ku e mbulojnë lulet dhe retë."

A kanë gërmuar arkeologët në këtë qyte? Ende asgjë, atje mbijnë bari e rriten plotë shëndet ahet shekullor, por rrënoja ka.

* * *

Është për tu theksuar se në hartimet e tjera të shkruar nga fëmijë Italian e të tjerë, janë rrokur tema sentimentale, romantike, tË jetës së përditshme. Përpiqemi të gërmojmë, në botën e brendshme të këtyre dy vogëlushëve, të cilët pavarësisht nga njëri-tjetri, tregojnë ngjarje që historia i lokalizon në kohë e hapësirë në trevat e *tyre te lindjes apo të origjinës*.

A nuk është e vërtet që poetët Arbëresh të Italisë apo të Egjyptit e Rumanisë me krijimet e tyre në poezi a poemat kanë pjalmin poetik të luftërave, të natyrës, të heronjve të Mëmëdheut të tyre?

Kush ka lexuar ato shprehet me plot bindje e afshin e shpirtit e të zemrës "*Sigurisht*,, Megjithatë debati në këto krijime të vockëla mbete i hapur për psikologët, mësuesit, profesorët, gjenetikanët, sociologët, etj.

Shembuj të tillë duhet të vegojnë si agimi i një mëngjezi bjeshke në fëmijët e emigrantëve që janë në New-York. Romë, Londër, Bruksel, Athinë, Berlin, Stamboll, Paris, Detroit, Vjenë, etj. Atëherë nuk mbetet gjë tjetër veçse t'i shkruajmë ti studiojmë e të nxjerrim përfundime të vlefshme.

Botohet libri "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit" nga prof. Dr. Bashkim Lleshi

Pse vendosa ta shkruaj këtë libër?

Në këtë libër përshkruhen disa nga përpjekjet modeste që kam bërë unë, si dhe përpjekjet e shumë intelektualëve e studiuesve dibranë e jo dibranë, për fillimin e punës për ndërtimin e "Rrugës së Arbërit", disa nga aktivitetet dhe përpjekjet e shoqatave "Nisma Dibrane" në Peshkopi, "Bashkësia Dibrane" në Tiranë, "Votra Dibrane"në Dibër te Madhe dhe "Lidhja e Intelektualeve Dibranë"në Tiranë.

Librin e kam titulluar "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit", meqenëse në këtë libër botohet i plotë Studimi gjeologo-inxhinierik, "Mbi kushtet Gjeologo-inxhinjerike dhe Gjeoteknike të rrugës Tiranë – Dibër", pjesë e Studimit të Fizibilitetit të kësaj rruge.

Në këtë libër botohen edhe përpjekjet e bëra para dhe pas kryerjes së Studimit të Fisibilitetit të rrugës, duke botuar artikuj sensibilizues në gazetën "Dibra", me kryeredaktor zotin Fatos Daci dhe 2 vitet e fundit në gazetën "Rruga e Arbërit", organ i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" me kryeredaktor zotin Shaqir Skarra, e cila nga prilli i këtij viti botohet si gazetë e pavarur me drejtor, biznesmenin dibran Rakip Suli dhe këshill botues, Musa Riçkun, Shaqir Skarrën e Bujar Karoshin.

Një vend të rëndësishëm në faqet e këtij libri zënë përpjekjet e bëra për përfshirjen në planin e shtetit të Studimit të Fizibilitetit të rrugës si dhe përpjekjet e bëra nga Studioja "Infratransproject Ltd" me drejtues Dr.Inxh.Faruk Kabën, gjatë dhe pas përpilimit të Studimit të Fizibilitetit.

Krijimi i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" në maj të vitit 2006 dhe organit të saj të shtypit "Rruga e Arbërit" i dhanë një shtytje të mëtejshme sensibilizimit të opinionit qytetar e shtetëror për të shpejtuar fillimin e punimeve për këtë rrugë.

Përpjekjet e kësaj Shoqate në bashkëpunim me Shoqatat e tjera Dibrane, me ndihmën e bashkëpunimin e shumë studiuesve dhe intelektualëve dibranë, matjanë etj., në bashkëpunim edhe me "Infratransproject Ltd" në Tiranë dhe "KIFER" në Shkup e Tetovë etj., u finalizuan në organizimin me 26 maj të vitit 2007 të Kuvendit Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit. Materialet e këtij Kuvendi janë botuar në një libër të veçantë me emrin "Rruga e Arbërit", në maj të vitit 2007.


Po në vitin 2007 doli nga botimi libri me të njëjtin emër "Rruga e Arbërit", me autor Dr. Faruk Kabën, ku jepet një përmbledhje e Studimit të fisibilitetit të kësaj rruge.

Gjatë vitit 2007 është kryer projekti i zbatimit të aksit të rrugës nga dalja e Bulqizës deri tek Ura e Çerenecit dhe në janar të vitit 2008 ka filluar puna në tre lote të këtij segmenti. Është për të ardhur keq për faktin që, megjithëse projektin e zbatimit e ka kryer e njëjta Studio që ka kryer Studimin e Fisibilitetit, në këtë projekt ka ndryshime nga aksi i miratuar në Studim, duke bërë një projekt zbatimi që është pothuajse rikonstruksion i rrugës ekzistuese, duke spekuluar me emrin e Rrugës së Arbërit.

Librin "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit" vendosa ta shkruaj në tremujorin e dytë të vitit 2008, duke e parë të nevojshme për të tërhequr edhe një herë vëmendjen që për pjesët e tjera të rrugës së Arbërit, në projektet e zbatimit, të ketë përmirësime të mëtejshme të variantit të miratuar, që kjo rrugë të jetë bashkëkohore dhe jo të ketë shmangie nga aksi i Rrugës së Arbërit të miratuar në Studimin e Fizibilitetit në vitin 2004, në dëm të cilësisë së rrugës.

Bashkim Lleshi

(Marrë nga libri "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit)



botime

Njerëz si Bajram Hyseni janë arkiva të gjallë,flasin vetë dhe nuk të lodhin shumë. T'i hapim pra sa nuk është vonë, se nesër mund të pendohemi për atë që bëmë sot.

Një emër sa i njohur aq dhe i venitur

Nga SHAQIR SKARRA

Kisha dëgjuar të flitej si në legjendë për shkrimtarin disident dibranë Bajram Hyseni. Atëherë ishim të vegjël dhe nuk e di se si më ra në dorë novela "Sllavianka" e cila ishte përkthyer në shtatë gjuhë të huaja.

Megjithëse kjo novelë u fut në karvanin e dokumentacionit të rremë e për diktaturën ishte vetëm një gotë lotësh derdhur nga autori për prishjen atëherë me Rusinë, për ne lexuesit e rrallë, që patëm fatin ta lexonim, "Sllavjanka", mbetet e mahnitëshme për nga stili dhe subjekti që trajtoi autori. Perlë e madhe për letërsinë shqiptare. Po kush është publicisti, poeti e shkrimtari Bajram Hyseni?

Një emër sa i njohur aq edhe i venitur. Lindi në brigjet e Drinit të Zi, në një natë të ftohtë dimri me borë e stuhi, e kjo stuhi do ta ndiqte jetën e tij hap pas hapi ose si një mallkim nga Zoti ose si një provë për të provuar vullnetin njerëzor. I njohur në Internatin e Kastriotit me djem e vajza të reja, por patriot dhe atdhedashës, u fut i ri në hullinë e luftrave.

Si pa kuptuar në moshë fare të njomë, kur mbi supe kishte vetëm 15 pranvera, u gjend partizan me armë në krah kundër fashizmit pushtues. Vite më vonë, pas çlirimit të vendit,Qamil Guranjaku, ish mësues në Internatin e Kastriotit, duke e ndjekur nxënësin e tij Bajram Hyseni me poezinë që botonte e fton që të punojë si bashkëpuntor tek gazeta "Luftëtari" organ i ushtrisë. Kështu punuan bashkë vite me radhë ish mësuesi dhe ish nxënësi i tij, Qamili si kryeredaktor dhe Bajrami si redaktor, deri sa erdhi momenti fatal për jetën e këtij shkrimtari që sapo ishte futur në hullinë e letërsisë por dhe aq pak kohë po shkëlqente në qarqet intelektuale. Meqenëse ky shkëlqim nuk u pëlqente të gjithëv,



arrestohet më 22 gusht 1964 dhe pas 14 muajsh hetuesi e dënojnë me 5 vjet burg për letërsi antisocialiste. Karvani i vuajtjeve dhe dënimeve të tjera të të mirënjohurit Bajram Hyseni sapo kishin filluar. Me një akuzë sa qesharake, aq edhe absurde dënohet përsëri në Peshkopi me 25 vite të tjera. Pse...?

Një kalvar i tërë vujtjesh dhe persekutimesh për njeriun e letrave shqipe.

Vetë 25 vjet burg,vëllai 23 vjet,djali atëherë nxënës në Liceun Artistik, gjoja donte të hidhte në erë Komitetin Qendror 20 vjet burg. Ndërsa gruaja e tij me djalin Arbenin, dhe vajzën Teutën, e cila kishte lindur dy javë pas arrestimit të tij, do të qëndronin në internim në Vrap të Tiranës deri në vitin 1991. Episod sa për të qarë dhe qeshur së bashku, por që kjo ka ndodhur vërtet. Bajrami vuante dënimin në kampin e Shën Vasisë në Sarandë. Më 26 mars 1991, vijnë që ta takojnë djali Dashamiri i cili sapo ishte liruar nga burgu dhe vajza e tij Teuta. Komandanti i kampit njofton Bajramin të dalë të takojë fëmijët tek porta. Tamam si në legjendë sepse dhe vetë jeta e Bajram Hysenit vjen sot tek ne si nëpërmjet legjendës.

Bajrami duke fërkuar sytë shprehet:"Këto nuk janë fëmijët e mi".

Djali i tij Dashamiri, duke përqafuar babanë e tij të thinjur dhe të plakur ndoshta para kohe qeshi, kurse vajza Teuta, 20 vjeçe, pa e njohur asnjëherë babanë e saj, veçse nëpërmjet fotografive, filloi të qante. Kishte plotësisht të drejtë, takoi më të dashurin e jetës së saj pas njëzet vjetësh. Por a mjaftonte me kaq për t'u hakmarrë kundër shkrimtarit Bajram Hyseni? E gjithë veprimtaria e tij e përmbledhur në 7 vëllime, si dhe koleksionet e gazetave, revistave të ndryshme ku kishte botuar u zhdukën. U zhduk dhe biblioteka me 2100 vëllime. Sot megjithëse i rëndojnë mbi supe mbi 84 vite jete, i urti, i mençuri, thesari i folklorit shqiptar Bajram Hyseni jeton.

Jeton për inat të kohës që kaloi dhe për inat të kësaj kohe bastarde, që po jetojmë të gjithë. Megjithëse shkopi e udhëheq në këtë trafik të ngjeshur makinash,mendja e tij është aq e freskët,sa kur hidhte me dorë të lirë novelat "Sllavianka", "Flaka" e "Shoferët". Ka gati dhe plot vepra për botime si, romane, monografi, poema dhe poezi. Ndoshta do të kujtohet dikush,zemërmirë e bujar, për të na lënë si trashëgimi këtë arkiv të gjallë të këtij autori sa të njohur, aq dhe të harruar. Provën e parë e dha Komuna e Çidhnës,duke i dhënë emrin shkollës 8-vjeçare në Laçes "Bajram Hyseni", si dhe duke e shpallur "Qytetar nderi " i komunës. Njerëz si Bajram Hyseni janë arkiva të gjallë,flasin vetë dhe nuk të lodhin shumë. T'i hapim pra sa nuk është vonë,se nesër mund të pendohemi për atë që bëmë sot.

botime & studio grafike

ju ofron botime cilësore dhe të standardeve bashkëkohore

libra - revista - gazeta - fletëpalosje - postera - broshura - kartolina - ftesa - kartvizita - shërbim fotografik....


00355 4 22 33 283
069 20 68 603
mbbotime@gmail.com

mirë.... bukur.... lirë....

NJË STUDIM SHKENCOR PËR BULQIZËN

Botohet libri i Ymer Ketës "Bulqiza dhe bulqizakët"

Ndoshta vonë, tepër vonë por më së fundi tashmë edhe Bulqiza ka historinë e saj të shkruar bukur dhe nëpërmjet një studimi të plotë shkencor nga autori Ymer Keta. Një punë disa vjeçare e autorit, birit bulqizak, një botim luksoz, një libër me vlera këto dit ka trokitur në portat e bulqizakëve por ndodhet e dhe në duart e të gjithë studiuesve që kanë dëshirë të njohin më mirë Bulqizën. E themi me bindje se libri "Bulqiza dhe bulqizakët" me autor Ymer Ketën është një enciklopedi e plotë, është një studim shkencor që botohet për këtë trevë aq të njohur por që pak është shkruar. Ymer Keta si bir i Bulqizës flet bukur e rrjedhshëm me argumenta bindëse dhe të dhëna shkencore, i ka befasuar këtë radhë të gjithë me këtë botim që na solli në votrat tona. Ky libër do të shërbejë për të gjithë bulqizakët si një libër tavoline e për studiuesit, për ato që duan të dinë më shumë për Bulqizën, si një busull orientuese. Në libër janë trajtuar të gjitha: Bulqiza në ngjarje dhe fakte, në gojëdhëna dhe legjenda, në doke dhe zakone, në folklor dhe kanun, në luftra dhe beteja, në besim dhe ateizëm, në etnogjenezën e fiseve dhe arsimimin e djemve dhe vajzave bulqizake. Domosdo duhet të jesh bir i kësaj treve, të jesh lindur dhe rritur në Bulqizë, të jesh vrarë duke lozur me gurët e Zallit të Bulqizës. Të jesh ngjitur në gurët e Skëndërbeut, të kesh vajtur në Vajkal, të kalosh më këmbë urën me harqe të qytetit. Të ngjitesh në Dhoks e të dalësh në Dragu, të futesh si besimtarë në teqet e Bulqizqës e të njohësh atdhetarët bulqizak si ato klerik dhe ato që drejtonin malin e Bulqizës. E këto autori i ka bërë. I ka bërë se është vetë bulqizak, është lindur dhe rritur në këto anë, ka lozur dhe është vrarë me gurë zalli, ka marrë pjesë në festat fetare dhe ato pagane që feston Bulqiza. Të gjitha i ka bërë se është vetë bulqizak dhe ka mallë gjithmonë për vendlindjen. Autori me një profesionalizëm të rrallë i ka thënë të gjitha. Ka shkruar për punën dhe hallet e këtyre banorëve që dallgët e jetës i kanë degdisur në këto anë. Për minierën e kromit aq të njohur në vitet e sistemit të kaluar. Rolin e klerikëve të Bulqizës si patriot por dhe fetar të shkolluar. I ka thënë të gjitha si njohës i mirë i kësaj treve. Ymeri e hodhi një gur në ngrehinën e themeleve të historisë së Bulqizës. Ka më për të thënë , domosdo që ka. Le të vijnë të tjerë dhe ta lartësojnë këtë ngrehinë e cila sapo ka nisur. Megjithatë Ymeri do ta thotë fjalën përsëri me profesionalizëm.



Kështu thotë që në hyrje të librit. Do të shkruaj për ato që punuan një jetë të tërë poshtë nëntokës së Bulqizës, do të shkruaj dhe për ato që sot nuk jetojnë më midis nesh por mbetën nën zgafellat e galerive të Bulqizës. Deri atëherë le të presim.

/ Sh. Skarra

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

duke u pajtuar dhe duke bashkëpunuar
gazeta hap faqet e saj për të rinjtë e shkollave, kryesisht për ata
që pretendojnë të fillojnë rrugën e gazetarisë, duke krijuar hapsira të posaçme
për krijimet e tyreletrare e publicistike...

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

www.dibra.org

Shkruaj dhe ti mendimin tënd!



AURORA GROUP SH.P.K

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon,
cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail:
auroragroup@auroragroup.com.al

"Risku" sh.p.k. dhe Market "Ken" ju urojnë gjithë klientëve:

Gëzuar Vitin e Ri 2009!

Tani më pranë jush me një market të ri
Pallatet KARAVAN, Laprakë


Tel: +355 4 22 50 480 - Cel. 068 20 36 394



Në treg

KALENDARI

"Dibra 2009"



Kalendari **"DIBRA 2009"** u realizua nga: **Bujar Karoshi** dhe **Hysen Uka**. *Fotografia:* **Gazmend Kërkuti.** *Sponsor kryesor:* **Aurora Group.** *Bashkëpunuan:* **Zyber Gjoni, Miranda Goleci, Zdenek Krejci - Çeki, Zven Jacobs - Austri, Griselda Kadria, Bardhyl Marku, Zaim Elezi - Zaya, Arben Sela, Andi Mimini,Adem Bunguri, Grehans Uka** *Ndalohet riprodhimi i fotografive pa lejen e autorëve*